

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Imam Ali Khamenei

FEMRA
TË DREJTAT, LIRIA DHE HIXHABI

Tiranë, 2020

Titulli i librit: Femra, të drejtat, liria dhe hixhabi

Autori: Imam Ali Khamenei

Përktheu: Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Korrekttoi: Vjollca Karaj

Përgatiti për shtyp & Kopertina: Sabrie Feza

Botues: Shoqata FLLADI

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

HYRJE

Femrës, i është bërë shumë padrejtësi, që në kohët e hershme. Madje vazhdon i bëhet edhe sot, në kohën e modernizmit. Midis abuzimit të parë dhe keqpërdorimit të dytë, femra ka jetuar në padrejtësi dhe errësirë të madhe, që përpiqet jo vetëm të lërë në harresë vlerën e saj, por edhe të verbojë humanizmin e saj, sepse ai që nuk e njeh vetveten, nuk lartësohet dhe as nuk përparon, kurse ai që e injoron vlerën e vet, nuk zhvillohet.

Ajo që kërkohet prej femrës, është jo vetëm përballja me këtë dukuri, por të nxjerrë në pah vetveten, të mos gabojë në diagnostifikimin dhe kurimin e kësaj dukurie. Përkundrazi, çdo gjë do t'i kthehet si bumerang, do të shkatërrohet e bashkë me të, do të shkatërrohet edhe shoqëria.

Kështu që gjendja e mirë e saj, përkthehet në mirësi për shoqërinë; prishja e saj është shkatërrim për shoqërinë; përsosja e saj mendore, shpirtërore dhe jetësore, do të reflektojë në shoqëri, si pjesë aktive, e rëndësishme, pasi ajo përbën gjysmën e shoqërisë.

Si rrjedhim, ajo duhet të marrë rolin për të cilën është krijuar.

Femra nuk është kurrsesi mashkull, sepse, nëse do të ishte e tillë, atëherë ajo do të ndante me të gjithë, ashtu sikurse edhe burri, nuk është femër, pasi edhe ai do ndante me të gjithë. Përkundrazi, secili prej tyre ka njohuri të veçanta, që plotësojnë njëri-tjetrin, duke bashkëpunuar për ndërtimin e jetës.

Udhëheqësi ynë, Imam Khamenei, me pikëpamjet e tij të mençura islame dhe udhërrëfimet e tij të drejta, na tregon jo vetëm për historinë e gruas, errësirën në të cilën ajo ndodhet, por edhe se si duhet të jetë ajo. Na tregon të ardhmen e saj.

Imam Khamenei, është imami i urtë, i mençur, është dielli vezullues për errësitat e femrës, njësoj sikurse mashkulli.

Po ju lëmë me orientimet e tij. Juve femra e djem, ju urojmë suksese të mëtejshme.

PJESA E PARË

GRUAJA

Rëndësia e trajtimit të çështjes së gruas

Kurimi i problemeve të gruas

Dështimi i qytetërimeve në zgjidhjen e çështjes së gruas

Figura e gruas përgjatë historisë

Rëndësia e trajtimit të çështjes së gruas

Imam Khamenei i kushton rëndësi të madhe trajtimit të temës së gruas, pasi ajo ka një rol të rëndësishëm, që, nëse neglizhohet, do ta çojë shoqërinë drejt shkatërrimit, humbjes dhe shpërbërjes, kurse, nëse i jepet haku, e drejta dhe roli për të cilin ajo është krijuar, do të sjellë një rezultat shumë të mirë, ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ana mendore e materiale.

Gruaja dhe burri janë ortakë në këtë jetë dhe secili prej tyre ka për detyrë të zbatojë rolin e tij, të marrë dhe t'i japë hakun njëri-tjetrit.

Kështu që neutralizimi i gruas, e cila përbën gjysmën e shoqërisë, apo bërja padrejtësi asaj, do të çojë në paralizimin e një organi shumë të rëndësishëm të shoqërisë, prej të cilës shoqëria do të jetë e prapambetur.

Imam Khamenei thotë: “Çështja e gruas është një problem shumë i madh, shumë serioz dhe ndikon shumë për të ardhmen.”

Pavarësisht hulumtimeve dhe studimeve të shumta që janë bërë përgjatë këtyre viteve në vendet islame, për problemet e shumta që i dalin gruas, apo rreth situatës së gruas iraniane, apo mënyrën se si e shikon Islami figurën e

gruas, akoma ka shumë punë të pakryera. Madje mund të themi se është bërë shumë pak deri tani.

Kur'ani i Madhërisëm i ka dhënë një rëndësi të veçantë gruas. Aq shumë përparësi i ka dhënë, sa që një sure e gjatë, emërtohet me emrin "Nisa". Kjo tregon gravitetin e elementit femëror në shoqërinë njerëzore, si dhe rëndësinë që i jep Islami, duke trajtuar me përkushtim e korrektësi çështjet e saj.

Pavarësisht rëndësisë së këtij elementi, historia dhe koha moderne i ka bërë padrejtësi femrës dhe nuk i ka kushtuar vëmendje rolit të saj, kjo për shkak se shoqëria, jo vetëm në kohët e hershme, por edhe në kohët e sotme, pavarësisht zhvillimit intelektual të jetës, nuk e shikon femrën si një element aktiv, e cila ka një rëndësi jo vetëm në ngritjen dhe ringjalljen e shoqërisë, por edhe në përsosjen e saj.

Kurimi i problemeve të gruas

Për peshën që ka gruaja në shoqëri, është e padiskutueshme dhe e nevojshme kurimi i problemeve të femrës, shqetësimet dhe brengat e saj, kështu që çdo lloj gabimi në diagnostifikimin dhe kurimin e problemeve, do të na çojë drejt destabilizimit të qenies dhe shkatërrimin e shoqërisë.

Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei, na thotë: “Fjalën time do ta filloj me fazën e rindërtimit rishtazi të këtij vendi islam, ku mbështetja më e madhe do jetë te fuqitë njerëzore.

Në këtë fazë, populli dhe përgjegjësit do të punojnë për rindërtimin e Iranit të madh, në aspektin material, në fushën e sistemeve shoqërore, si edhe në aspektet shpirtërore.

Cilido vend që dëshiron, t’i rikthehet ndërtimit të tij të vërtetë, patjetër që kujdesi më i madh duhet të jetë kah njeriut dhe fuqive njerëzore. Kur ne flasim për fuqitë njerëzore, duhet ta spostojmë shikimin drejt asaj, që femra formon gjysmën e banorëve të këtij vendi, si dhe gjysmën e forcave njerëzore. Nëse diku, gjendet ndonjë pikëpamje e gabuar për gruan, atëherë nuk ka asnjë dyshim se rindërtimi, në kuptimin e vërtetë të tij dhe të një standardi të lartë, nuk do të arrihet kurrë.”

Dështimi i qytetërimeve në zgjidhjen e çështjes së gruas

Cilido që e shqyrton historinë dhe aktualitetin, do të shohë se çështja e gruas nuk është kuruar ashtu siç duhet.

Udhëheqësi ynë, Imam Khamenei, thotë: “Për sa i përket çështjes së gruas, e cila ende vazhdon të paraqitet në botë, janë thënë e stërthënë shumë gjëra, por, kur shikojmë hartën njerëzore të botës dhe shoqëritë njerëzore, si dhe shoqëritë islame, sikurse vendi ynë dhe gjithë vendeve të tjera islame dhe shoqërive joislame, pjesë e tyre janë edhe shoqëritë që konsiderohen të modernizuara, është për të ardhur keq, sepse në të gjitha këto shoqëri, ne gjejmë një problem me emrin “femra”, e cila ende vazhdon të jetë i pranishëm.

Ky problem tregon për ekzistencën e një lloj pikëpamjeje dhe historiku të deformuar, si dhe na tregon për ekzistencën e një lloj miopie kah problemeve njerëzore.

Nga kjo bëhet e qartë se, pavarësisht të gjitha pretendimeve dhe mundimeve që kanë bërë njerëzit e sinqertë dhe entuziastë, pavarësisht të gjitha përpjekjeve kulturore që janë bërë rreth çështjes së gruas në veçanti, akoma nuk është gjetur rruga e drejtë dhe e vërtetë, lidhur me çështjen e dy gjinive, si dhe çështjen e gruas, të cilën e ndjek në një mënyrë apo një tjetër çështja e burrit.

Unë shpresoj që mes jush, o gra të nderuara, të ketë nga ato që kanë parë apo kanë lexuar veprat kulturore dhe artistike të artistëve të botës aktuale në gjuhën e tyre origjinale, ose nga ajo që është përkthyer në gjuhën perse. Që të gjitha ato vepra, flasin për të njëjtin problem, për të cilën ne po flasim. Kjo do të thotë se njerëzimi, deri më sot, akoma nuk ka mundur t'i japë zgjidhje jo vetëm çështjes së femrës dhe problemeve gjinore që e ndjekin atë, por edhe çështjeve njerëzore.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri, nuk ka asnjë dyshim se keqpërdorimi, trajtimi i devijuar dhe keqkuptimi, si dhe çdo lloj padrejtësie që kanë prodhuar, si vakumi shpirtëror, probleme familjare, probleme që lidhen me përzierjen ndërmjet tyre, si dhe lidhjet ndërmjet dy gjinive, që të gjitha këto çështje, vazhdojnë akoma të jenë pjesë e problemeve që njerëzimi akoma nuk i ka dhënë zgjidhje.

Njerëzimi që ka zbuluar trupat qiellorë dhe ka depërtuar thellë në thellësitë e oqeanëve, na flet me detaje për psikologjinë dhe studimet e saj, si dhe na flet për problemet dhe çështjet shoqërore, ekonomike e të tjera si këto, përballë kësaj çështjeje (të femrës), vazhdon të jetë i dobët, aq sa, nëse unë do të doja të sqaroja dhe të listoja titujt e kësaj dobësie, do të kisha nevojë për shumë kohë."

Figura e gruas përgjatë historisë

Pasi na u bë e qartë nga fjala e udhëheqësit, rëndësia e elementit femëror, si dhe domosdoshmëria e zgjidhjes së vërtetë të çështjeve të femrës, është mirë, që t'i kthehemi pak historisë, që të shikojmë padrejtësinë që i është bërë femrës përgjatë historisë dhe se si historia dështoi në vlerësimin e gruas dhe kurimin e problemeve të saj shpirtërore.

Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei, thotë: “Sikur njeriu të shikonte mirë, do të gjente, me keqardhje, se ka një padrejtësi historike në dëm të gruas gjatë gjithë historisë. Burimi më i madh i kësaj padrejtësie është injoranca për pozitën dhe vlerën e femrës. Ky problem ekzistonte te të gjitha vendet.

Unë jam i bindur se padrejtësia e ka ndjekur femrën përgjatë historisë dhe në shoqëri të ndryshme, për shkak të injorancës së njerëzve, pasi natyrshmëria e njerëzimit është injoranca, ku i forti i bën padrejtësi të dobët, përveçse në rastet, nëse do të kishte një forcë të jashtme që e mbante nën kontroll, si p.sh, ligji, shpata e ligjit dhe shkopi i tij, ose, në brendësi të njeriut do të ekzistonte një parandalues, si p.sh, një besim i fortë, i vetëdijshëm dhe i qartë. Fatkeqësisht, kjo është diçka shumë e rrallë.”

Le të ecim shkurtimisht me historinë, që të shikojmë se si është panorama e historisë rreth gruas.

a- Gruaja tek arabët, në kohën e injorancës

Në kohën e injorancës, gruaja tek arabët, ishte më e nënçmuara se çdo lloj malli, saqë nuk merrte asnjë trashëgimi dhe nuk kishte të drejtë të kërkonte. Martesa e saj i përkiste kujdestarit të saj, nuk kishte të drejtë të kundërshtonte dhe as të këshillohej, aq sa edhe djali nuk ia lejonte të vesë së babait të vet që të martohej. Femrës i ndalohej të martohej përveçse me të afërmit të vet, për shkak të ekzistencës të së drejtës së gjakut ndaj saj!

Arabët, njësoj sikurse edhe popujt e tjerë të lashtë, gëzoheshin shumë kur bëheshin me djalë dhe hidhëroheshin aq shumë kur i lindte vajzë, sa shkonin deri aty, sa i varrosnin femrat të gjalla.¹

b- Gruaja në vendet e Persisë

Situata e femrës nuk ka qenë më e mirë se sa në vendet e Nilit (Egjipt) dhe vendeve të Kinës. Ligjet e Zodoasterit kanë qenë të padrejta në dëm të femrës. Ato ligje i jepnin asaj ndëshkimin më të rëndë, edhe nëse bënte gabimin më të vogël.²

c- Femra në vendet e Greqisë

¹Merjem Nuruddin, "Femra nën hijen e Islamit", nga faqe 12 e tutje.

²I njëjti burim, f. 26.

Te grekët, femra ishte krijesa më e poshtëruar, deri në kulmin e poshtërimit dhe të mizorisë, në të gjitha aspektet e jetës shoqërore. Kurse për sa i përket prestigjit, nderimit dhe respektit në shoqëri, këto ishin privilegje të burrave.

d- Femra në vendet romake

Ligjet dhe rregullat romake anonin kah padrejtësisë, ndalimit dhe persekutimit ndaj femrës.

Kështu, burri, në shoqërinë e tyre, kishte në familje të drejta të plota të pronësisë. Brenda kësaj situate, femra pati një reagim të kundërt, pas një farë kohe dhe filloi të tërhiqej kah rrjedhës së korrupsionit. Si rrjedhim, morali, në shoqërinë romake, filloi të shturej gjithmonë e më shumë. Pasionet dhe epsheet shpërthyen, kurse teatrot u bënë shfaqje të lakuriqësisë dhe stolisjes së urryer.³

Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei, këtu na tregon një gjest të rëndësishëm. Midis të tjerash, ka thënë: “Thelbi i qytetërimit modern evropian është kultura romake, domethënë, se rrënjët dhe vijat që ekzistonin në Perandorinë Romake janë ato që udhëheqin të gjithë kulturën perëndimore. Pas saj qëndrojnë kultura amerikane dhe llumi i Perëndimit. Ky, pra, është sot standardi.

³ I njëjti burim, f. 29-30.

Në ato kohë të lashta, ata e ngrinin në një shkallë të lartë femrën, e respektonin dhe e zbukuronin me lloj-lloj stolish. Por për çfarë qëllimi? Për të kënaqur tiparin njerëzor të burri, që është qenia më e fëlliqur dhe më materialiste. Kjo është fyerje e madhe dhe përbuzje për njeriun dhe gjininë femërore.

Edhe në Iran ka qenë e njëjta situatë. Ju keni dëgjuar për këshillat e grave të mbretërve sasanë. Çfarë kuptimi kanë ato salla dhe këshilla të grave? Me të vërtetë, ajo do të thotë fyerje dhe përbuzje e gruas. Një burrë i vetëm ka fuqinë dhe ia lejon vetes së tij, që të ruajë njëmijë femra në sallonin e tij. Sikur të gjithë individët e popullit të tij do të kishin një fuqi të tillë, secili prej tyre do të kishte nën kujdes për veten e tij njëmijë femra apo pesëqind, katërqind apo dyqind. Çfarë optike do të ishte kjo për femrën?!”

e- Femra indiane

Femra merrej në pronësi dhe burri për të kishte statusin e mbretit apo të idhullit. Pastaj, pas këtij poshtërimit dhe përbuzje, e çonin si sakrificë në zjarrin e bashkëshortit

të saj të vdekur, duke e hedhur të gjallë në zjarr. Indianët ia ndalonin femrës të gjitha të drejtat e pronësisë, edhe atë të trashëgimisë. Ata ia dorëzonin lloj-lloj mashkulli, pa miratimin dhe dëshirën e saj. Populli indian besonte se femra është lëndë paudhësie dhe adresimi i degradimit moral dhe shpirtëror dhe nuk ia njihte ekzistencën e personalitetit të pavarur si një qenie e përsosur.⁴

PJESA E DYTË

⁴ I njëjtiburim, f. 31-32.

QYTETËRIMI PERËNDIMOR

Padrejtësia aktuale është vazhdim i padrejtësisë së hershme

Padrejtësi “elegante”

Femra në kulturën perëndimore

Islami është konkurrues

Lëvizjet për çlirimin e femrës, në Perëndim, janë lëvizje shfrytëzuese dhe përfituese

Të këqijat e Perëndimit (e tëra është tragjedi)

Reforma e re në Perëndim

Kultura perëndimore duhet të mbrojë veten e saj

Padrejtësia aktuale është vazhdim i padrejtësisë së hershme

Ajo çfarë cituam, ishte një histori e errët dhe e padrejtë për femrën, deri në ekstrem. Mirëpo, a ka mësuar ndonjë gjë qytetërimi perëndimor nga historia? Është për të ardhur keq, se ai akoma vazhdon të jetë dështak, në kurimin e çështjes së femrës dhe nuk ka përfituar fare nga leksionet e historisë, përkundrazi ka përfituar gabim, duke shpërdoruar problemin e femrës. Padrejtësia vazhdon akoma ta ndjekë femrën, në një mënyrë apo një tjetër.

Udhëheqësi ynë, Imam Khamenei, thotë: “Padrejtësia për të cilën ne po flasim, nuk është vetëm e shoqërisë iraniane dhe as veçori e të shkuarës, përkundrazi ajo i zgjat tentakulat nga e shkuara deri në ditët e sotme. Ajo sot është e pranishme në çdo cep të botës, edhe në vendet perëndimore, në veçanti në Amerikë. Nuk po e përcjell këtë lajm nga burimet e armiqve dhe kundërshtarëve të tyre, por kjo është ajo që vetë ata e botojnë dhe e shpërndajnë. Pa dyshim se dëmtimi i femrës, shfrytëzimi në mënyrë të padrejtë, torturimi dhe mundimi në mënyrë shtazarake, për të cilën ka të dhëna statistikore, të bëra lajm në gazetë perëndimore amerikane, me patjetër duhet t’i dilet përballë, duhet t’i vijë fundi.”

Padrejtësi “elegante”

Ajo që është e rrezikshme për padrejtësinë perëndimore të femrës, është se ajo kalon përmes rrugës së

parullave dhe dukurive mashtruese. Kjo është një padrejtësi e rrezikshme, që buron nga njerëzit më budallenj dhe naivë.

Udhëheqësi i nderuar, Imam Khamenei, thotë: “Të gjithë duhet ta kthejnë vëmendjen se kjo padrejtësi ekziston në të gjithë botën, por në botën perëndimore ekziston në formën më të ligë. I gjithë problemi është se perëndimorët kanë barazuar femrën me mashkullin, njësoj si bashkëpunimi ndërmjet femrës me femrën dhe bashkëpunimi midis burrit me burrin. Kjo do të thotë se ata nuk kanë bërë një ndarje midis këtyre dy gjinive. Po ta shikojmë me vëmendje, do të vëmë re se kjo çështje është diçka negative.

Ndonjëherë ata na shfaqen, sikur nuk ka dhunë ndaj femrës. Kjo është situata e tyre në familje, tregje dhe shtëpi, në sjellje, në bashkëjetesë dhe shoqërim. Kjo mund të duket tërheqëse, mirëpo po të futemi më në brendësi të çështjes, do të shohim se nuk është e vërtetë. Islami e ka hedhur poshtë dhe ka vendosur një perde ndarëse midis burrit dhe gruas dhe që të dy e kanë për detyrë të kujdesen dhe ta ruajnë atë kufi në marrëdhënien e tyre.”

Një prej parullave që hedhin perëndimorët, për të na hedhur hi syve, është, “Liri, drejtësi dhe barazi”. Mirëpo, nëse shikohet me vëmendje, brenda kontekstit të këtyre parullave, në kuptimin perëndimor, do të gjejmë se këto parulla janë shkatërruese.

Udhëheqësi ynë, Imam Khamenei, thotë: “Parulla e parë që hidhet nga Perëndimi, është liria e femrës. Mirëpo liria ka një kuptim të gjerë. A përfshin kjo gjë: lirimimin nga robëria, çlirimimin nga morali, ku edhe morali konsiderohet një kufizim në vetvete; lirimimin nga ndikimi i të tjerëve, në bazë të shfrytëzimit të gruas nga pronarët dhe tërheqja e saj për të punuar me një pagesë më të vogël; çlirimimin nga ligjet që e detyrojnë femrën me detyra ndaj bashkëshortit të saj. A mund t’i quajmë liri, të gjitha këto kuptime?

Të gjitha këto parulla janë një propagandë e përhapur nga kërkesat dhe pritshmëritë që përplasen plotësisht me njëra-tjetrën. Pra, çfarë do të thotë liri?

Është për të ardhur keq, sepse kuptimi i lirisë që shtrohet dhe prezantohet në Perëndim, është liria, me kuptimin e saj të gabuar dhe shkatërrues, domethënë liria nga zinxhirët dhe kufijtë e familjes. Madje edhe liria nga detyrimet e martesës, formimit të familjes dhe edukimit të fëmijëve, për ta zëvendësuar të gjithë këtë qëllim erotik tranzit. Pra, nuk është liria, me kuptimin e saj të vërtetë. Në lidhje me këtë, do të shohësh se në mesin e fjalës së hedhur në Perëndim, është çështja e lirisë së abortit. Ky është një problem shumë i madh, pavarësisht se, në pamje të jashtme, duket i vogël dhe i thjeshtë, mirëpo brendësia e tij është e thellë dhe shumë e rrezikshme. Këto janë mënyrat dhe parullat që hedh Perëndimi, prandaj edhe thonë ‘Rilindje e lirisë së gruas’.”

Femra në kulturën perëndimore

Udhëheqësi ynë, Imam Khamenei, e kthen shikimin te një çështje shumë e rëndësishme: realiteti i sjelljes së perëndimorëve me femrën nuk njihet nëpërmjet parullave që ata hedhin, por nëpërmjet edukatës dhe kulturës së tyre.

Imam Khamenei thotë: “Perëndimorët kanë rënë në një pakujdesi dhe neglizhencë, në aspektin e njohjes së natyrës së femrës dhe sjelljes me gjininë femërore. Pikëpamja e Perëndimit ndaj gruas, ka qenë e ngritur mbi mungesën e barazisë.

Ju femra, mos i shikoni parullat që hedh Perëndimi. Ato janë parulla boshe, të kota dhe tregojnë realizmin relativ, sepse kultura perëndimore nuk mund të kuptohet nëpërmjet këtyre parullave, përkundrazi kjo kulturë perëndimore duhet të studiohet nëpërmjet arsimimit perëndimor.

Me të vërtetë, ai që është i mirinformuar për letërsinë perëndimore, poezinë evropiane, letërsinë, historinë, tregimet dhe shfaqjet evropiane, e di fare mirë se kultura evropiane, që prej shekullit të mesëm e deri në vitet e fundit të shekullit XX, e shikonte femrën si një krijesë të dorës së dytë. Cilido që pohon të kundërtën e kësaj, flet kuturu.

O femra, shikojini mirë shfaqjet e Shekspirit anglez. A e shikoni se me çfarë shpirti, gjuhe dhe optike i shikojnë ata femrat në këto shfaqje dhe në të gjitha llojet e letërsisë perëndimore? Burri, në letërsinë perëndimore, është padroni i femrës dhe kujdestari i saj. Një pjesë e modeleve të kësaj kulture, bashkë me gjurmët e saj, vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në ditët e sotme.

Tani, kur femra martohet dhe shpërngulet në shtëpinë e burrit të saj, ndryshon mbiemrin e vajzërisë dhe merr mbiemrin e burrit të saj. Kjo është ajo tradita perëndimore. Kjo nuk ka ndodhur më parë në vendet tona e as tani nuk ndodh, pasi femra e ruan identitetin e familjes së saj, edhe pasi martohet. Ajo që ndodh sot në Perëndim, është tregues i kulturës së vjetër perëndimore, e cila e konsideron burrin padronin e gruas.

Pra, kultura perëndimore vlerësonte se gruaja, kur të martohej me një burrë dhe të shpërngulej në shtëpinë e tij, atëherë, pa dyshim se trupi i saj dhe çdo gjë që ajo kishte, bëhej pronë e burrit. Këtë gjë, perëndimorët kurrsesi nuk mund ta mohojnë.

Në kulturën perëndimore, kur gruaja shkonte në shtëpinë e bashkëshortit të saj, ai, burri, kishte në dorë edhe shpirtin e saj. Prandaj edhe ju gjeni nëpër tregime dhe poezi evropiane e perëndimore, se si bashkëshorti e vriste bashkëshorten e vet, për shkak të dallimeve morale dhe askush nuk e fajësonte atë për këtë.

Vajza në shtëpinë e prindit nuk kishte asnjë të drejtë zgjedhjeje. Sigurisht se në ato kohë, edhe bashkëjetesa midis gruas dhe burrit ka qenë e nxehtë në mesin e perëndimorëve, ndërsa zgjedhja e bashkëshortit ka qenë vetëm në dorë të babait.

Këto janë ndikimet e letërsisë perëndimore. Deri në mesin e shekullit aktual, këto kultura qeverisnin, kurse në fund të shekullit të IX, filluan disa lëvizje, nën emrin ‘Liria e femrës’.”

Islami është konkurrues

Shkëlqesia e tij, udhëheqësi ynë, Imam Khamenei ka theksuar se Perëndimi, shumë vonë, është kujtuar të mbajë lart flamurin e lirisë së femrës dhe se zhurma perëndimore,

rreth lirisë së femrës, nuk është gjë tjetër veçse një mbulesë e prapambetjes historike, ku fshiheshin perëndimorët.

Ai thotë: “Pavarësisht gjithë këtyre zhurmave, ulërimave dhe pretendimeve që bëjnë e hedhin këto vende, në mbështetje të gruas dhe pozitës së saj njerëzore, nuk ka dyshim se ky produkt i gabuar, me keqardhje, po vazhdon të ekzistojë akoma. Evropianët janë shumë prapa vendeve arabe, në lidhje me kurimin e problemit të femrës.

Në të gjithë Evropën, deri edhe në dekadat e fundit të këtij shekulli, femrës i ndalohej e drejta edhe për të votuar, si dhe nuk kishte as të drejtën e trashëgimisë të pasurive të saj.

Që prej dekadës së fundit, domethënë që prej viteve 1916 apo 1918, vendet evropiane vendosën që gradualisht t’i jepnin femrës të drejtën e shfaqjes së mendimit, të trashëgimisë, si dhe barazinë e të drejtave shoqërore me mashkullin.

Në bazë të kësaj, pa dyshim se Evropa u zgjua vonë nga gjumi i saj letargjik, në lidhje me këtë aspekt. E perceptoi me vonesë problemin, saqë duket sikur ajo, me ndikimin e saj, dëshiron që me këtë zhurmë mashtruese, të riparojë prapambetjen e saj kohore.”

Lëvizjet për çlirimin e femrës, në Perëndim, janë lëvizje shfrytëzuesedhe përfituese

Udhëheqësi, Imam Khamenei, thotë: “Unë mendoj se perëndimorët i kanë nënshtruar konceptet njerëzore përreth femrës për dobi të çështjeve mediatike, politike dhe ekonomike. E tillë ka qenë çështja në Evropë, që në fillim. Qëkur gruas i dhanë të drejtat, ia dhanë më të shumtën mbi bazë të atyre parimeve të gabuara.

Nga studimet e sakta të dijetarëve të komunitetit në Evropë, bëhet e qartë se Evropa vendosi për të drejtën e pronësisë së gruas, për një tjetër qëllim, që lidhet me përhapjen e fabrikave, duke zhvilluar teknikën dhe industrinë moderne. Mirëpo këto fabrika kishin nevojë për krah pune, punëtorë.

Në fillim të shekullit XX, duke bërë thirrje për të drejtat e grave për pronësinë, donin t’i tërhiqnin femrat drejt fabrikave, që të përfitonin nga forca e tyre. Ata gjithmonë i jepnin gruas pagesë më të vogël se sa burrit.

Pa dyshim se subjekti i gruas është bërë njësoj si pjesa tjetër e subjekteve të mallrave në dorë të njerëzve shfrytëzues dhe matrapazë të vlerave njerëzore.

Janë ata që nuk e peshojnë as femrën, as racën njerëzore dhe as urtësitë njerëzore, përveç llogarive të tyre financiare. Ata luajnë një rol të rëndësishëm në qytetërimin perëndimor, në të gjitha aspektet e jetës. Ata e konsiderojnë çështjen e fermës një mall dhe kapital të marrëveshjeve në tregjet e ndryshme, flasin rreth saj dhe e portretizojnë atë si

një kulturë dhe media që i përshtatet atyre në rrethin e tyre, i nxis mendjet e burrave dhe të grave në të gjithë botën, drejt bulevardit të ngacmimit dhe humbjes së madhe.”

Të këqijat e Perëndimit (e tëra është tragjedi)

Si rrjedhim i gabimeve skandaloze që ka bërë Perëndimi, në diagnostifikimin dhe kurimin e çështjeve të gruas dhe ndërmjet një historie mospërfillëse dhe aktualiteti abuzues, u shfaqën intriga dhe kurthe të rrezikshme në shoqërinë evropiane dhe amerikane, të cilat herët apo vonë, futën në kurth këtë qytetërim, duke e çuar drejt rënies.

Shkëlqesia e tij, udhëheqësi ynë, Imam Khamenei, thotë: “Kjo pikëpamje është abuzuese, e gabuar dhe e padrejtë. Ky është abuzimi që pranon, gjithashtu, edhe neglizhencën, pasi, nëse fryn era e kryengritjes për të mirën e gruas, në këtë lloj situatë, atëherë është e natyrshme që të abuzohet me palën tjetër përballë, prandaj edhe ju e shikoni se si është përhapur korrupsioni dhe e keqja në Perëndim përgjatë disa dekadave, për shkak të lirisë absolute të gruas, e cila ka shkaktuar frikë dhe panik te vetë mendimtarët perëndimorë.

Nëse ti lexues i dashur, dëshiron të thellohesh në informacione për të këqijat e shoqërisë perëndimore, mjafton të lexosh gazetën, revistat dhe statistikat perëndimore dhe do të çuditesh. Ne po të japim disa informacione për këto punë të liga:

Statistikat thonë se një e gjashta e femrave britanike që lidhin kurorë, janë shtatzëna, si shkak i lidhjeve mëkatore që paraprijnë martesën. Në Amerikë, çdo vit lindin 400 mijë fëmijë të jashtëligjshëm.

Thuhet se në Francë, para Luftës së Parë Botërore, niveli i degjenerimit ishte kaq i madh, sa numri i prostitutave shkonte deri në 500 mijë.

Statistikat e sotme tregojnë se në Francë, numri i divorceve që bëhen në vit, ka arritur në katër milionë dhe ka rreth 1 milionë vajza. Statistikat tregojnë se një e katërta e fëmijëve të lindur janë nga incesti. Policia franceze, çdo vit, regjistron 22 mijë krime përdhunimi. Vetëm Allahu i Madhëruar e di më së miri numrin e ngjarjeve të tjera, viktimat e të cilave pengohen që t'ia komunikojnë autoriteteve.⁵

Për të mos përmendur sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si: Sida, Sifilizi, etj.⁶ Duke shtuar më tej shkatërrimin e bërthamës së familjes në Perëndim, prishjen e lidhjeve farefisnore të shoqërisë midis bijve të së njëjtës familje, si dhe përhapjen e vrasjes dhe krimit.

Udhëheqësi, Imam Khamenei, thotë: “Ju e shihni ku ka arritur gjendja e shoqërive perëndimore: miliona të rinj të humbur, korrupsioni, është ulur këmbëkryq, ndërtesa të larta, baza bërthamore dhe qiellgërvishtës. Pavarësisht zhvillimit shkencor dhe industrial, të rinjtë adoleshentë jetojnë si të humbur, si hajdutë, vrasës, trafikantë, si përdorues të cigares dhe lëndëve narkotike. Në vendet perëndimore, pavarësisht parullave që përhapen, gratë

⁵Revista “Nurul Islam”, nr. 2, f. 79.

⁶Shih të njëtin burim, f. 101.

përballen me dhunën bashkëshortore brenda familjes, vajzat rrihen dhe plagosen nga dora e prindërve të tyre. Me lehtësi, bëjnë vrasje. Ka statistika të dhimbshme dhe të frikshme në këtë aspekt të perëndimorët, duke i shtuar edhe një problem tjetër, që është vetëvrasja. Me lehtësi të paparë, ato presin damarët. Vrasja e femrave është një nga fatkeqësitë më të përhapura në vendet perëndimore e sidomos në Amerikë.”

Reforma e re në Perëndim

Përveç pikëpamjes së gabuar, në lidhje me çështjen e femrës, duke i shtuar edhe listën e gjatë të gjërave të liga, në

rrugët perëndimore, u shfaqën zëra dhe lëvizje të reja në mbrojtje të të drejtave të gruas dhe lirisë sa saj.

Është për të ardhur keq, kur në shoqëritë islame dëgjojmë thirrës, që bëjnë thirrje për të ndjekur përvojën perëndimore, ndërkohë që atje, në elitën perëndimore, ngrihen zëra për ndryshimin e një pjese të rrugëve të gabuara, në lidhje me femrën.

Imam Khamenei thotë: “Shumë femra që flasin sot për të drejtat e grave, në realitet, shpалosin lirinë dhe paturpësinë perëndimore, duke imituar traditën perëndimore. Vetë ato janë prej atyre që bëjnë ndonjë shkrim, herë pas here, për disa çështje.

E sikur kopja perëndimore rreth femrës të ishte e vërtetë, perëndimorët nuk do të ishin të detyruar pas shtatëdhjetë, tetëdhjetë apo njëqind vitesh, të hedhin hipotezën e revolucionit të ri, në mbrojtje të të drejtave të gruas, sikurse e kanë propozuar së fundmi.

Tani, përgjatë njëzet viteve të shkuara, ata janë rikthyer të bëjnë lëvizje të reja në mbrojtje të të drejtave të gruas dhe lirisë e saj. Përse?

Sikur liria perëndimore të ishte një çështje e suksesshme, sikur mbrojtja e të drejtave të gruas të ishte diçka reale, nuk do të kishte nevojë që një pjesë të merrnin

nismën për të propozuar këtë lëvizje pas njëqind vitesh dhe të tërhiqnin kaq shumë vëmendje.

Pra, receta e tyre e mëparshme ka qenë e gabuar. Gjithashtu, edhe receta e tyre reale është e gabuar dhe kurrë nuk do t'i kthehen gruas apo burrit dhe në veçanti gruas me ndonjë mënyrë tjetër, përveçse me mjerim dhe gjetje të problemeve të reja.

Shikojeni këtë shkrimtar perëndimor (Majk Matheus) se çfarë thotë, kur bën thirrje për reformë: “Nëse ti e shfaq veten tënde para të tjerëve, me një mënyrë tërheqëse, me anë të veshjes, është e natyrshme që shumë meshkuj do ta dëshirojnë trupin tënd për epsh, pa parë fare, nëse ti je një femër që ke personalitetin, karakterin dhe mënyrën tënde të menduarit.”

Në një fragment tjetër, Majk Matheusi thotë: “Meshkujt gabojnë, nëse mendojnë me epsh dhe pasion përpara femrës, e cila vesh rroba skandaloze, mirëpo mashkulli i edukuar, dëshiron të largohet nga ky mendim. Ne shpresojmë që femra, me dëlirësinë e saj dhe duke veshur rroba të hijshme, të na ndihmojë ne në këtë drejtim.”

Duke vazhduar më tej, ai thotë: “Femra nuk duhet të mashtrohet nga ekspozimi, që bëjnë dyqanet e rrobave të modës, pasi kjo gjë, zgjon seksin te çdo person. Detyra jote nuk është të veshësh rroba tërheqëse, që të mbërthesh një mashkull të ri. Ata vetë dëshirojnë të marrin kënaqësinë e

tyre të seksit, prandaj i nxisin femrat, që të veshin rroba të tilla, mirëpo ti femër nuk duhet ta shfaqësh trupin tënd, që të marrësh një burrë të ri.”⁷

Policia britanike ka hedhur në qarkullim një broshurë me titull “Për mbrojtjen e personalitetit të femrës”, e cila përmban këshilla për të shmangur përdhunimin, këshilla për të mos veshur rroba skandaloze, provokuese, si dhe këshilla për të qenë sa më modest.⁸

Në Amerikë, shkollat dygjinore çuan në rezultate të këqija, në largimin e studentëve dhe të studenteve nga metodat studimore, në përgjithësi. Për këtë, studiuesit e arsimit morën vendimin për të ndarë shkollat e djemve nga ajo e femrave, në fazën fillore dhe atë të mesme.⁹

Ndërkohë që këto zëra qarkullojnë në mesin e tyre, ne shikojmë se në vendet islame bëhen të njëjtat thirrje që bëjnë reformatoret perëndimorë.

Në Turqi, pavarësisht ligjit që u miratua në fillim të viteve 1991 dhe e dekretoi Presidenti turk, në lidhje me lirinë e veshjes së hixhabit në të gjitha institucionet arsimore, administrata e universitetit të Ankarasë, vendosi të mos i

⁷Revista “Nurul Islam”, Nr. 87-88, f. 46.

⁸I njëti burim, f. 47.

⁹I njëti burim, nr. 2, f. 80.

lejojnë të hyjnë në kampusin universitar studentet që veshin hixhabin.¹⁰

Kurse në një vend tjetër islam, Egjipt, në vitin 1991, administrata e televizionit vendosi të ndalojnë spikeret që shfaqen në ekranet e televizionit të veshura me hixhab.¹¹

Kultura perëndimore duhet të mbrojë veten e saj

Vetëbesimi është prej bazave të përparimit të njeriut, në të gjitha aspektet. Po kështu, prej bazave të zhvillimit të

¹⁰I njëti burim, nr. 21-22, f. 106.

¹¹I njëti burim, nr. 21-22, f. 106.

çdo populli, është që ai të ruajë identitetin e tij, të besojë ligjin dhe legjitimitetin e fesë së tij.

Të respektojë veten dhe të mos mposhtet përballë propagandave, thashethemeve dhe shfaqjeve mashtruese. Është për të ardhur keq, që në mesin e ymetit tonë ka njerëz që rrënohen përpara Perëndimit, pasi dëshirojnë që të ecin në hapat e Perëndimit, me gjithë negativitetin e tij, prandaj edhe sot, ata dhe shumica që i ndoqën kanë rënë në bankën e të akuzuarit për ta mbrojtur veten përballë qytetërimit perëndimor. Ata dhanë ndihmën e tyre në shpartallimin psikologjik të shoqërisë islame.

Udhëheqësi, Imam Khamenei, ka dashur ta kthejë imazhin dhe të miratojë autencitetin, pastërtinë dhe përsosjen e fesë sonë, prandaj ne e kemi për detyrë që të jemi të qetë, kurse ata e kanë për detyrë të mbrohen.

Shkëlqesia e tij, imam Khamenei, thotë: “Perëndimorët duhet të përgjigjen për atë që i kanë bërë gjinisë femërore. Ata e kanë mashtruar femrën. Pa dyshim se qytetërimi perëndimor nuk i ka ofruar asnjë gjë femrës.

Nëse atje kemi zhvillim shkencor, politik dhe ideologjik, atëherë ai është arritur nga vetë gratë kudo që ekzistojnë këto çështje, në Iranin islamik apo edhe vende të tjera.

Perëndimorët dhe qytetërimi perëndimor ka ndërtuar ngrehinën e shturjes, të imoralitetit, të vulgaritetit psikologjik. Ata e tërhoqën femrën drejt vulgaritetit dhe nuk e rregulluan situatën e saj brenda familjes. Gazetaria dhe instrumentet e medias amerikane dhe evropiane flasin për një standard të lartë të lëndimit të femrës, torturimit, ndëshkimit dhe terrorizimit të tyre.

Nuk ka dyshim se kultura perëndimore rreth femrës, vulgarizimi dhe tërheqja e femrave të atyre zonave drejt këtyre, ka çuar në dobësimin e familjes, e ka lëkundur edhe ndërtimin e familjes, ka bërë që burri dhe gruaja të mos e konsiderojnë si një çështje shumë të rëndësishme tradhtinë brenda familjes. A nuk është ky një mëkat? A nuk është kjo një tradhti për gjininë femërore? Pavarësisht asaj kulture, ata i kërkojnë botës që t'u përshtaten atyre, ndërkohë që ata duhet të dënohen për këtë.

Kultura perëndimore duhet ta mbrojë veten, në aspektin e gruas, duhet të japë sqarime, mirëpo kapërcimi i fuqisë kapitaliste dhe mjetet e fuqishme arrogante të komunikimit masiv perëndimor, e ka kthyer çështjen në anën e kundërt. Dhe janë ata vetë, që dënojnë të tjerët dhe kanë bërë pjesë të tyre mbrojtjen ndaj të drejtave të gruas, sipas fjalës dhe pretendimit të tyre. Ndërkohë që nuk ekziston fare diçka e tillë.

Sigurisht, në mesin e perëndimorëve ka mendimtarë, filozofë, njerëz të sinqertë dhe reformatorë, të cilët mendojnë dhe flasin të vërtetën.

E për sa i përket asaj që thashë më lart, ajo është kultura e përgjithshme, qytetërimi perëndimor dhe kundërvajtjet e tyre kundër gruas, për t'i bërë dëm asaj.”

PJESA E TRETË

SHKAQET DHE MËNYRA E KURIMIT

Shkaqet e padrejtësisë ndaj femrës

Trajtimi i të drejtave të femrës

Shkaqet e padrejtësisë ndaj femrës

Udhëheqësi, Imam Khamenei, ka bërë thirrje për studimin e shkaqeve të shtypjes së femrës dhe trajtimin e kësaj padrejtësie.

Ne e kemi për detyrë të kërkojmë dhe ta studiojmë këtë padrejtësi që ka rënë mbi femrën, përgjatë historisë.

Injoranca e njerëzve

Unë kam bindjen se padrejtësia e ka ndjekur femrën përgjatë historisë dhe në shoqëri të ndryshme.

“Sikurse kam cituar, unë kam folur për burimin e kësaj padrejtësie, që bëhet për shkak të injorancës së njerëzve, pasi është natyra e njeriut, që i forti i bën padrejtësi të dobët, përveçse nëse ekzistojnë forca të jashtme, që e kontrollojnë dhe e pengojnë atë, sikurse ligji apo të ketë një parandalues në brendësi të njeriut, si besimi i fortë, i vetëdijshëm dhe i qartë. Por kjo është një situatë shumë e rrallë.”

Ngacmimi i meshkujve

“Arsyeja pse meshkujt ngacmojnë femrat është se ata janë më trupmëdhenj, kanë zë më të lartë, janë më të fortë, të fuqishëm, në krahasim me femrat që janë më trupvogla, më të imta, me zë më të butë dhe delikate. Ky është realiteti dhe mendoj se, nëse ju femra hulumtoni çështjen, do t’ju bëhet e qartë se ky është burimi i ngacmimit të ju.

Mashkulli perëndimor, gjithashtu, me rolin e tij, në një mënyrë apo një tjetër, i bën padrejtësi femrës.

Një prej shenjave që tregon autoritetin e burrit perëndimor ndaj gruas, është se ai e konsideron gruan si një vegël për burrin, prandaj edhe kërkon prej saj që të zbukurohet për të dhe të bëhet më tërheqëse për të. Ky është dominim, pushtet për burrin dhe jo liri për femrën, madje ajo, në realitet, është liri për burrin. Ata duan të jenë të lirë me kënaqësinë vizuale, prandaj edhe e nxisin femrën, që të stoliset dhe të zbukurohet përpara meshkujve.

Pa dyshim se ky egoizëm i meshkujve është i pranishëm në shoqëritë që nuk përfitojnë nga feja e Zotit. Ka qenë që në kohët e hershme dhe ekziston edhe në kohët e sotme dhe perëndimorët janë ekspozuar më shumë ndaj kësaj.”

Përftimi material

Pa dyshim se femra është bërë njësoj si pjesa tjetër e mallrave, në dorë të njerëzve shfrytëzues dhe matrapazë të vlerave njerëzore.

Janë ata që nuk peshojnë as femrën, as racën njerëzore dhe as urtësitë njerëzore, përveç llogarive të tyre financiare. Ata luajnë një rol të rëndësishëm në qytetërimin perëndimor, në të gjitha aspektet e jetës, si dhe e konsiderojnë çështjen e fermës një mall dhe kapital të marrëveshjeve në tregjet e ndryshme, flasin rreth saj dhe e portretizojnë atë si një kulturë dhe media që u përshtatet në rrethin e tyre, i nxisin mendjet e burrave dhe të grave, në të gjithë botën, drejt bulevardit të ngacmimit dhe humbjes së madhe.

TRAJTIMI I TË DREJTAVE TË FEMRËS

Mosimitimi i verbër

Me keqardhje, unë mendoj se ata që mbrojnë të drejtat e femrës, bien në kurthin e gabimeve dhe kështu mbrojtja e tyre nuk i bën asnjë dobi femrës. Me fjalë të tjera, ata e shikojnë të çuditshme gjendjen e femrës dhe e marrin si shembull për veten e tyre, në kohën kur kultura e saj ndryshon totalisht me kulturën islame, sepse kultura islame është shumë më lart në gradë dhe më e dobishme për gjendjen e femrës se sa ajo kulturë.

Urtësia dhe mosveprimi

Nuk ka dyshim se çdo lloj lëvizje shoqërore, do të jetë e vërtetë dhe do të ketë rezultate të drejta, kur të jetë e bazuar mbi urtësinë, meditimin, diagnozën, interesin dhe e ndërtuar mbi shtylla të drejta dhe racionale. Çdo lëvizje që synon realizimin e të drejtave të femrës, ajo patjetër që duhet ta vërejë mirë këtë koncept, domethënë, çdo lëvizje duhet të nisë nga një pikëpamje e mençur, e ndërtuar mbi të drejtat e ekzistencës, pra, mbi njohjen e natyrës së femrës dhe natyrshmërisë së saj, si dhe natyrës së burrit dhe natyrshmërisë së tij, përgjegjësitë dhe angazhimet specifike për gruan dhe përgjegjësitë dhe angazhimet specifike për burrat, si dhe gjërat që mund të ndahen ndërmjet të dyve. Lëvizja të mos niset nga tradita dhe prejardhja, sepse, nëse lëvizja niset nga këto pika, atëherë ajo do të jetë një lëvizje e dëmshme.

Nëse dikush, në vendin dhe shoqërinë tonë iraniane, do të fliste për femrën dhe të drejtat e saj, duke u nisur nga revistat dhe vendimet perëndimore apo politikanët perëndimorë, pa dyshim se lëvizja e tyre do të ishte e gabuar. Nuk duhet të futesh në këtë fushë me këtë qëllim, sepse përfundon në gabim.

Nëse i futemi fushës së mbrojtjes ndaj femrës, me qëllim që të mos jenë të prapambetur ndaj Perëndimit, atëherë përsëri do të jemi të gabuar.

Nëse futemi në këtë fushë, me qëllimin që të mos na shikojnë ata me syrin negativ, atëherë përsëri do të jemi të gabuar.

Nëse hyjmë në këtë fushë, me imagjinatën dhe mendimin se ata (perëndimorët) kanë gjetur rrugën e drejtë, atëherë do të jemi akoma më shumë në gabim.

Me keqardhje, unë sot shikoj se një pjesë e citimeve që shkruhen nën sloganin e mbrojtjes së gruas, si dhe disa thënie që hidhen nën sloganin, për ligjja e të drejtave të gruas, niset plotësisht nga influenza, sepse perëndimorët kanë thënë kështu, sepse evropianët kanë shkruar kështu dhe, sepse neve na akuzojnë për këtë. Nëse ne marrim pozicion mbrojtës dhe e zbatojmë atë, atëherë kjo gjë do të na mashtrijë dhe do të na largojë nga rruga e drejtë. Ne e kemi për detyrë të shohim dhe të kuptojmë të vërtetat e botës së ekzistencës dhe shumica e këtyre të vërtetave ekzistuese janë në mësimet islame.

Manifestimi i të drejtave të gruas me gjuhën e kohës

Çështja tjetër e rëndësishme, është manifestimi i mendimeve islame për të drejtat e gruas dhe të burrit. Femrat e kanë për detyrë, që të jenë edhe ato aktive në këtë aspekt. Mirëpo aktiviteti kryesor bie mbi ata që ia kanë vënë shpatullat dijeve islame, për të bërë të mundur shfaqjen e mendimit islam, në ato fusha ku të drejtat e femrës bien në konflikt me të drejtat e burrit.

Që të qetësohen të gjithë, ato të drejta janë caktuar mbi bazë të natyrës dhe natyrshmërisë njerëzore të femrës dhe mashkullit dhe në bazë të interesave të shoqërisë.

Sigurisht, shumë gjëra kanë ndodhur deri tani, mirëpo këto çështje duhet të përmbushen sot me gjuhën e kohës.

Domosdoshmëria e distancimit nga studimet devijuese

“Një pjesë bart sloganin e mbrojtjes ndaj femrës dhe e tërheq studimin drejt labirinteve. Disa të tjerë shtrojnë çështje për paratë e gjakut e të tjera si këto. Këto studime devijojnë nga tema dhe mendimi i Islamit është i qartë. Kushdo që shtron çështje të tilla, do të çojë vetëm në zgjatje të rrugës, largimin dhe mashtrimin e mendjeve.”

Reformimi dhe ndryshimi i ligjeve

Disa ligje, në lidhje me trajtimin e gruas dhe të burrit, kanë nevojë për ndryshim. Specialistët e kësaj fushe duhet ta studiojnë problemin dhe t'i riparojnë ato ligje.

Qëllimi i mirë

Nuk ka dyshim se synimi ynë në këtë përballje (në mbrojtjen e të drejtave të gruas) dhe nga kjo qeveri dhe nga ajo që kemi tani, është të fitojmë kënaqësinë e Allahut. Ne jetojmë dhe marrim frymë, disa ditë këtu, pastaj shkojmë atje. Njeriut nuk i bën dobi asgjë, përveç kënaqësisë së Allahut.

Ju gra, bëni që qëllimi juaj të jetë kënaqësia e Allahut. Synoni të afroheni tek Allahu, me veprat dhe mundin tuaj. Punoni për Allahun dhe Allahu do t'ju ndihmojë juve. Mos futni treguesit perëndimorë në punën tuaj.

PJESA E KATËRT

FYTYRA E NDRITSHME

Islami është zgjidhja

Gruaja në shoqërinë islame

Mbrojtja e gruas ndërmjet kulturës perëndimore dhe asaj islame

A ka dallim midis burrit dhe gruas?

Hixhabi

Dallimi midis hixhabit të kohës së injorancës dhe hixhabit islam

Disa nga objektivat e hixhabit

Margjinat e çështjes së hixhabit (shikime dhe mbrojtje)

El abaetu është lloji më i mirë i hixhabit

Modele islame

Islami është zgjidhja

Pas gjithë asaj pamje të zymtë, të errët e të padrejtë që paraqitëm për gruan, që prej kohës së injorancës së arabëve, të cilët i varrosnin ato të gjalla, nuk u linin trashëgimi, nuk i bënë pjesë të pronës, nuk kishin të drejtë zgjedhjeje në martesë, duke vazhduar më tej, me kohën e injorancës persiane, kineze, indiane, romake, greke, ku gruaja ishte një pronë, fati i së cilës ishte i panjohur, e burgosura e shqetësimeve dhe e anktheve të saj, duke kaluar më tej, në injorancën e kohës moderne, injoranca e Amerikës dhe Evropës, ku femra në Angli, deri në kohët e vona, shitej në tregje si skllave, kurse bashkëshorti mund ta blinte gruan e tij, duke paguar një sasi të vogël parash.

E tillë ka qenë gruaja, deri në kohët e vona, në shumë prej vendeve evropiane, e cila nuk kishte të drejtë pronësie.

Pas gjithë këtij imazhi të zymtë, ku është ajo drita që do të ndriçojë këtë errësi? Ku është fytyra vezulluese e femrës? Ku është rruga e drejtë, vija që nuk ka as abuzim dhe as keqpërdorim, por një peshore të drejtë, që nuk bën padrejtësi dhe nuk frikëson? Cila fe dhe cila rrugë do ta ndalojë dhunën ndaj gruas dhe nënshtrimin e saj? Si do ta ndalojë dhunën?

Nuk ka asnjë dyshim se ajo që do ta parandalojë atë dhunë, janë dy gjëra:

E para: Frika ndaj Allahut, respektimi i ligjit dhe ringjallja në zemër e besimit.

E dyta: Femra duhet të jetë e mirinformuar për të drejtat e saj njerëzore dhe hyjnore, ta mbrojë atë dhe të gjejë vetveten në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Në këtë aspekt, Islami bën të qartë kufirin e mesëm, pa asnjë lloj abuzimi. As femrën nuk e lejon të bëjë mëkat, as nuk e neglizhon natyrën e gruas dhe të burrit, përkundrazi e qartëson mirë vijën dhe rrugën e drejtë, që është rruga islame.

Nuk ka dyshim se ka shumë mangësi dhe probleme, por cila është kura? Kurimi është që ne të drejtohemi nga zgjidhja hyjnore dhe ta gjejmë atë, sepse zgjidhja hyjnore, bart në vetvete, çështje të rëndësishme, rreth çështjes së gruas dhe burrit.

Po, unë jam plotësisht dakord me atë që ju gra keni thënë, që bota bashkëkohore është shumë e etur për të dëgjuar thirrjen e feve dhe pa dyshim, nga të gjitha fetë që pretendon fuqinë e saj për ndërtimin e shoqërisë, në të gjitha fushat e jetës, është feja islame.

Vërtet, kristianët bashkëkohës dhe pjesa tjetër e feve, në një farë mënyre, nuk e pretendojnë diçka të tillë, ndërsa Islami pretendon se ai ka shtyllat e ndërtimit të sistemit shoqëror dhe mund të ngrejë shtyllat e saj dhe mbi ato

shtylla të ndërtojë një sistem shoqëror dhe një shoqëri të shëndoshë dhe të përparuar.

Ajo që doja të thosha, është se për çdo mangësi që ekziston për gjendjen e gruas në shoqërinë tonë, ka edhe një kurë, sepse Islami e shikon gruan me një vizion gjithëpërfshirës, të përsosur. Patjetër që duhet të gjendet mënyra e kurimit.

Ky ka qenë synimi kryesor i kësaj çështjeje, kur formova Këshillin Kulturor Shoqëror të Gruas. Ne sot e kemi për detyrë, që të shikojmë se për çfarë mjetesh ligjore kanë nevojë femrat, që të ecin drejt rrugës që dëshiron Islami për femrën dhe cilat janë mendimet dhe reflektimet e duhura; cilat janë orientimet që u nevojiten atyre dhe cilat janë qendrat udhërrëfyese që duhet të ekzistojnë patjetër.

Gruaja në shoqërinë islame

Edhe pse Islami është ilaçi i çështjeve të gruas, nuk duhet të mohohet realiteti, që shoqëria islame ka nevojë për më tepër impenjim, për të reformuar dhe për të rregulluar situatën e femrës, si p.sh: një legjislacion i integruar, një ligj më i plotë, por nuk gjen përkrahës që të marrin përgjegjësitë e plota.

Udhëheqësi, imam Khamenei, thotë: “Lëvizja drejt njohjes së të drejtave të gruas në shoqërinë islame dhe në shoqërinë tonë, është diçka që duhet bërë patjetër, por ajo duhet të jetë mbi bazën islame dhe me qëllim islam.

Askush të mos thotë se ç’është kjo rilindje, ç’është kjo lëvizje, si dhe çfarë i mungon gruas në shoqërinë tonë? Është për të ardhur keq, sepse një pjesë mund të mendojë se ajo është një pikëpamje virtuale, pasi femra ankohet prej dhunës dhe zhveshjes së meritave për të cilat ajo është obliguar në të gjitha shoqëritë dhe, njëra prej tyre, është edhe shoqëria jonë. Mirëpo, për lirinë, kjo mangësi nuk është me kuptimin e paturpësisë, përkundrazi ajo është mangësi në ofrimin e mundësive për të marrë dijen, edukatën, etikën, përparimin, zbulimin dhe zhvillimin e fuqive. Kjo gjë duhet t’u garantohet dhe duhet t’u studiohet atyre me patjetër. Kjo është ajo që e miraton dhe e forcon Islami.”

Shumë energji janë shpenzuar dhe, pavarësisht kësaj, duhet të bëhet një punë më e madhe kulturore, rreth çështjes së gruas, të drejtat e saj, zhdukjen e dhunës ndaj saj, si dhe sigurimin e kushteve dhe të terrenit për lëvizjen e gruas.

“Unë sot propozoj studimin tim, me këtë nijet, që është mbështetja në shfaqjen e kësaj atmosfere kulturore, sepse, nëse atmosfera jonë kulturore bëhet transparente, në aspektin e çështjeve të gruas, nëse qartësohen mirë ligjet islame dhe mendimet kur’anore në këtë fushë, atëherë do të admirohet rruga para grave të vendit tonë, që t’u mundësohet arritja te pika që konsiderohet qëllimi dhe objektivi i kërkuar. Pavarësisht se ky është vetëm një studim, një fjalë apo fjali, në realitet, është një punë, sepse ajo fjalë do ta bëjë atmosferën tonë kulturore transparente dhe mendjet të hapura.”

Mbrojtja e gruas ndërmjet kulturës perëndimore dhe asaj islame

Gjatë viteve të fundit, ne kemi parë përpjekje që meritojnë të vlerësohen. Në vendin tonë, problemet e femrës, janë trajtuar edhe në fushat ideologjike dhe kulturore. Mirëpo ka një pikë thelbësore: Cili është qëllimi ynë i bisedës, për të drejtat e gruas apo rreth përmirësimit të kushteve të përsosjes sonë dhe zhdukjes së dhunës ndaj saj? Cili është objektivi i përpjekjeve tona, i shkrimeve, i fjalimeve dhe i aktiviteteve ligjore? Këto pyetje janë shumë e rëndësishme.

Ka dy qëllime për aktivitetet kulturore dhe të drejtat e njeriut, që mund t'i përshkruajmë, me qëllim arritjen e pikës së kërkuar të të drejtave të femrës, në të dyja aspektet, atë shoqërore dhe individuale:

I pari është përpjekja, shkrimi, të folurit, me qëllim që femra të arrijë përsosjen e saj ekzistenciale, domethënë, pikësëpari, femra të marrë të drejtën e saj njerëzore dhe realiste në shoqëri.

I dyti, rritja e përgjegjshmërisë së saj, që të gjejë zhvillimin e saj real dhe njerëzor dhe në fund të përfitojë përsosjen njerëzore, që ajo të marrë formën e saj të plotë njerëzore në shoqëri, për t'u bërë një njeri që jep kontributin e vet për zhvillimin e njerëzimit dhe të shoqërisë, që bota,

në kufijtë e forcave të saj, të shndërrohet në një parajsë të lumtur dhe të bukur.

Qëllimi tjetër është se ne, nëpërmjet fjalimeve për të drejtat e femrës, fatkeqësisht, mund të fabrikojmë një situatë konflikti, konkurrence, armiqësore midis dy gjinive, burrit dhe gruas. Në këtë pikë, burrat, në njërën anë dhe gratë, në anën tjetër, përleshën për përfitimet e tyre. Kështu, gruaja, dëshiron ta mundë burrin. Po a është ky qëllimi?

Atëherë, ekzistojnë dy pikëpamje që mund ta përshkruajnë qëllimin e kësaj përpjekjeje dhe lëvizjeje, me një mënyrë tjetër të shprehuri, rilindje. Synimi i parë është një qëllim islam, kurse synimi i dytë, është një qëllim dritëshkurtër (miopi).

Ne i shikojmë më shumë gjurmët e qëllimit të dytë te përpjekjet që bëhen në vendet perëndimore.

A ka dallim midis burrit dhe gruas?

Udhëheqësi, imam Khamenei, thotë: “Nuk ka dyshim se trajtimi i vërtetë dhe korrekt është ai që merr në konsideratë dhe përfill natyrën e gruas, pasi gruaja nuk e harron natyrën e saj dhe nuk ka interes ta harrojë, sepse kjo natyrshmëri është shumë ndikuese për të gjithë sistemin. Kjo situatë është ndikuese dhe e domosdoshme, pasi, në të kundërt, nëse këtë gjini e zëvendësojmë realisht me një gjini tjetër, ose ia ndryshojmë karakteristikat e saj, atëherë ne e kemi zvogëluar përsosjen. A nuk është kështu?

Ne e kemi për detyrë ta lëmë gruan të mbetet grua dhe burrin të mbetet burrë, që të përsoset ky grupim, pasi në kundërt, nëse e shndërrojmë burrin në grua, në të gjitha karakteristikat e tij, etikën, biografinë, detyrat dhe punët e tij, kurse femrën e kemi shndërruar në mashkull, çfarëdo që të veprojmë prej këtyre dy gjërave, kemi bërë një gabim të madh.

“Doemos do t’i shpie ata në rrugë të shtrembër, do t’i josh me shpresa të kota dhe, me siguri, do t’i urdhëroj që t’u presin veshët bagëtive, e pastaj do t’i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e Allahut. ‘Kush merr djallin për mbrojtës në vend të Allahut, ai ka pësuar humbje të qartë.’”¹²

Kjo shprehje, për krijesën e Zotit, është përmendur në Kur’an. Ne do ta zhdukim sistemin e plotë të krijimit, atë

¹²Sure “En Nisa”, ajeti 119.

sistem që formon nevojën e këtij grupi gjinor me këto karakteristika, prandaj edhe raca gjinore është me ato karakteristika, tipare që secili të plotësojë tjetrin.

Pa dyshim se Islami mbështet përsosjen e njerëzimit, nuk bën dallim midis burrit dhe gruas, sepse Islami nuk përqendrohet te gjinia mashkullore apo femërore, përkundrazi, Islami përpiket për përsosjen e njerëzimit.

Islami, herë flet për burrin e herë tjetër, flet për gruan, herë nderon e respekton gruan e herë tjetër, nderon burrin. Kjo bëhet për të treguar se ata të dy janë elementë të ekzistencës njerëzore. Nuk ka asnjë dallim midis atyre të dyve, për nga aspekti njerëzor dhe hyjnor, prandaj edhe kur flitet në Kur'an e Allahu flet për njeriun punëmirë dhe njeriun e keq, Ai jep shembull për ata të dy. Ai merr dy shembuj për gratë dhe thotë: **“Allahu ka dhënë si shembull për ata që nuk besojnë, gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga robtë Tanë të ndershëm dhe i tradhtuan ata. Prandaj, ata nuk mund t’i mbrojnë aspak nga Allahu (Ditën e Gjykimit) e atyre të djave do t’u thuhet: ‘Hyni në zjarr, me ata që po hyjnë!’.”**¹³

Për njeriun besimtar merr një shembull: **“Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha: ‘O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek**

¹³Sure “Et Tahrim”, ajeti 10.

Ti, në Xhenet; më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës!.”¹⁴

Ai na jep një shembull të plotë për rrugën e drejtë dhe rrugën e gabuar, duke përmendur gratë, kurse në një vend tjetër, flet për burrat. Islami nuk përqendrohet te seksi mashkull apo femër, përkundrazi ai përqendrohet te lartësimi i njerëzimit, tek etika njerëzore, në largimin e forcave të brendshme dhe është e domosdoshme njohja e natyrës së secilit prej tyre.

Islami e njeh shumë mirë natyrën e mashkullit dhe të femrës. Ajo që hidhet në Islam, është teza e drejtësisë, domethënë ruajtja e drejtësisë së pastër midis individëve të njerëzimit, duke e përmbledhur, pra, midis dy gjinive, burrit dhe gruas, barazia në të drejta. Në disa aspekte, ne shohim se ligjet e gruas ndryshojnë nga ligjet e burrit, sepse natyra e gruas ndryshon nga natyra e burrit. Prandaj edhe shumica e të vërtetave dhe realiteteve të natyrshmërisë njerëzore, rreth gruas dhe burrit, janë të pranishme në dijet islame.

Pa dyshim se roli i gruas është i padiskutueshëm në tri gjëra:

¹⁴Sure “Et Tahrim”, ajeti 11.

1-Në kufijtë e përsosjes njerëzore

Nuk ka asnjë dyshim se optika e Islamit është: **“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtares, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), duruesit dhe durueset, të përlururit dhe të përlururat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”**¹⁵

Ajeti përmend dhjetë cilësi për të dy gjinitë, burrin dhe gruan, pa asnjë diskriminim.

2- Roli i gruas në jetën sociale

Duke nisur nga aktivitetet politike, ekonomike, shoqërore dhe ngjashëm me të (intelektuale), me fjalë të tjera, grua luan një rol të rëndësishëm në shoqëri.

¹⁵Sure “ElAh’zab”, ajeti 35.

3- Roli i gruas në familje

Pra, në hapësirën e parë, hapësira e udhëzimit shpirtëror, lartësimit të shpirtit dhe vetes për njeriun, nuk ka dallim midis gruas dhe burrit, sepse gruaja është njësoj si burri dhe burri është njësoj si gruaja, që të mund t'i ngjisin gradat e larta shpirtërore dhe të arrijnë afërsinë hyjnore.

Hapësira e dytë është hapësira e aktiviteteve shoqërore që përfshin: aktivitetin ekonomik, politik dhe shoqëror, në kuptimin e tij të veçantë. Ajo fusha shkencore, e arsimit, e mësimdhënies dhe punëve të rënda në rrugë të Allahut, xhihadi dhe të gjitha hapësirat e jetës shoqërore.

Edhe në këtë hapësirë nuk ka asnjë dallim midis burrit dhe gruas në praktikimin e aktiviteteve të ndryshme, në të gjitha fushat, në optikën islame. Ai që thotë se burri mund të studiojë, kurse gruaja jo, se burri mund të merret me politikë, kurse gruaja jo, nuk është i qartë në logjikën islame dhe fjala e tij është në kundërshtim me fenë islame.

Po, ka punë që nuk i vijnë për shtat fare gruas dhe as nuk harmonizohen me ndërtimin e saj trupor, sikurse ka disa punë që nuk i përshtaten fare burrit dhe as nuk harmonizohen me gjendjen e tij morale dhe trupore. Mirëpo kjo nuk ka asnjë lidhje me aftësinë apo paaftësinë e femrës për praninë e saj në hapësirën e aktiviteteve shoqërore,

sepse ndarja e punëve bëhet sipas mundësive, dëshirës dhe kërkesës së çdo pune.

Nëse ekziston dëshira te femra, ajo mund t'i kryejë aktivitetet e ndryshme shoqërore dhe çdo gjë që ka lidhje me shoqërinë. Pjesa e tretë dhe shumë e rëndësishme është familja.”¹⁶

Kur’ani dhe Syneti flasin qartë për lirinë e femrës dhe se nuk ka dallim midis gruas dhe burrit (me përjashtim të rasteve të caktuara, për një qëllim të caktuar).

Vërtet, nëse marrim Kur’anin e Madhërishëm, do të shohim se nuk ka asnjë sure në të që të argumentojë barazinë midis burrit dhe gruas, pa asnjë dallim, në raportin e të drejtave, të detyrave dhe pasojave.

Këtë nuk e argumentoj nga metodika kur’anore, për njehsimin e fjalës, në formën femërore dhe mashkullore, në lidhje me të drejtat dhe pasojat që lidhen me të gjitha degëzimet e aktivitetit njerëzor në fusha të veçanta dhe të përgjithshme të jetës, sepse, pa dyshim, fjala i drejtohet gjithmonë gruas dhe burrit në një nivel të vetëm, pa bërë asnjë dallim, siç thuhet në ajetin: **“O ju që keni besuar, Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe ju ndamë ju në popuj e fise që të njiheni me njëri-tjetrin,**

¹⁶Libri “Roli i gruas në familje”, që flet për këtë temë, është botuar në qendren e Imam Khomenit (r.a), prandaj edhe nuk po e analizoj këtu.

me të vërtetë më i miri ndër ju tek Allahu është ai që është më i devotshmi.”¹⁷

Ka shumë hadithe profetike që e mbështesin këtë. Është për të ardhur keq, sepse në shoqërinë islame ka citime që hidhen pa u studiuar, njësoj si ajo thënia që thotë për mangësitë e grave nga mendja. Njerëzit e marrin, e përpunojnë dhe e transmetojnë gojë pas goje, sikur ajo të jetë e dorëzuar fetarisht.

Shkëlqesia e tij, udhëheqësi ynë, imam Khamenei, na ka treguar strukturën mendore të femrës, duke thënë: “Gruaja nuk është më pak se burri, për nga struktura mendore. Ndonjëherë është më e fortë se sa burri, mirëpo kuptimi i gruas ndryshon nga kuptimi i burrit, lloji i shqisave të gruas ndryshon nga shqisat e burrit. Secili prej atyre të dyve ka ardhur në ekzistencë për një detyrë të posaçme, në harmoni me të dhe kjo është depozituar në ekzistencën e individëve. Në përballjen me disa çështje shkencore, nuk ka asnjë dallim midis burrit dhe gruas, mirëpo ka dallim midis atyre të dyve, për mënyrën e jetesës.”

Pra, citimi i mësipërm, atëherë është i saktë, jo në mënyrë absolute, por ka një kuptim që nuk pakëson gjë nga vlera e gruas, përsosja, logjika dhe puna e saj.

¹⁷ Sure “El Huxhurat”, ajeti 13.

HIXHABI

Një luftë për hixhabin dhe thirrje për të qëndruar fort

Pa dyshim se çështja e hixhabit dhe çdo çështje që lidhet me femrën, është bërë një vegël në dorën e abuzuesve dhe të të gjithë atyre që kanë qëllim të keq, për të sulmuar mediatikisht Islamin.

Vetvetiu, bëhet e qartë, se ky informacion i lig, do të lërë gjurmë negative te rinia, nëse nuk mbrohet njaftueshëm mendërisht.

Udhëheqësi, imam Khamenei, na flet rreth sulmit ndaj hixhabit: “Kur të shikoni një pjesë të vendeve perëndimore dhe disa vende islame që qeverisen nga qeveri joislame, do të kuptoni se si armiqtë e Islamit e luftojnë hixhabin. Kjo e bën mëse të qartë se sa të interesuara janë femrat për hixhabin në ato vende.

Kemi përmendur dy vende islame, ku hixhabi, në institucionet e tyre arsimore dhe mediatike, është ndaluar. Edhe sistemi i Shahut punonte që t’ua ndalonte

myslimaneve hixhabin, duke përhapur thashethemet e zbulimit të fytyrës dhe trupit.

Përgjatë periudhës së sistemit diktatorial, një pjesë e tyre e trajtonin hixhabin me përbuzje dhe tallje. Në atë periudhë kohe ka pasur një numër shumë të kufizuar të grave dhe vajzave që frekuentonin universitetin e që mbanin hixhabin veshur. Ato përballeshin shumë shpesh me përbuzje dhe tallje. Nuk ka dyshim se një trajtim i tillë është çnjerëzor dhe i gabuar. Kjo është ajo që përcjellin burimet mediatike përëndimore në kohët e sotme.”

Sa shumë fjalë përçmuese dëgjojmë ne për femrat e veshura me hixhab, në disa prej shoqërive tona: “Hixhabi është për plakat e vjetra! Hixhabi është prapambetje! Hixhabi të ndalon ty të shfaqësh bukurinë tënde! Hixhabi nuk të lë të lëvizësh lirisht! Hixhabi është një traditë e kohës së shkuar!” Lista është e gjatë. Brenda gjithë kësaj sasive përbuzjesh dhe akuzash, ajo vajza e re dhe e dobët rrëzohet përpara tyre dhe nuk e di se të gjitha këto akuza janë të pavërteta. Nëpërmjet tyre synohet që të ulin poshtë vlerën e gruas dhe humanizmin e saj.

Shkëlqesia e tij, udhëheqësi ynë, imam Khamenei, ka bërë thirrje për të qëndruar të palëkundur dhe të mos ndikohemi nga përbuzja dhe mosrespektimi i pamatur. Midis të tjerash, thotë: “Është detyrë e grave të ditura dhe të zgjuara të Iranit, që të vazhdojnë rrugën e tyre të qartë dhe të ecin përpara, duke hedhur hapa të sigurt e të

qëndrueshme. Rinia revolucionare dhe gratë besimtare duhet të distancohen nga veprat e atyre njerëzve sipërfaqësorë, të harruar e të pavëmendshëm, si dhe të kenë kujdes rikthimin e zbukurimit të kotë dhe prirjet jo revolucionare. Të kenë kujdes përjetimin e kohës së injorancës dhe të mos përzihen me diçka të papëlqyeshme.

Dallimi midis hixhabit të kohës së injorancës dhe hixhabit islam

Disa thonë se hixhab, në Islam, do të thotë burgosje e gruas në shtëpi, pa e parë dritën e diellit, pa e shijuar jetën. Kurrsesi jo. Nuk ka asnjë dyshim se hixhabi islam është një mbulesë e ndërtuar mbi baza logjike dhe të mençura.

Udhëheqësi, imam Khamenei, thotë: “Veshja e hixhabit nuk do të thotë lënia e gruas në një qoshe. Nëse dikush konstaton se hixhabi është lënia në një qoshe të harruar, ky konstatim i tij është i gabuar, devijues dhe nxitës i të keqes.

Në të vërtetë, hixhab (mbulesë) do të thotë kufiri i përzierjes dhe paturpësisë midis gruas dhe burrit në shoqëri, sepse, pa dyshim, kjo përzierje është e dëmshme dhe shkatërruese për shoqërinë e sidomos për femrat, kështu, pra, hixhabi nuk ka ndikim ndaj aktiviteteve politike, shoqërore dhe shkencore. Absolutisht, nuk e pengon femrën.”

Pra, përfundimisht, hixhabi islam është çlirim dhe lëvizje e lirë dhe jo vetizolim e vdekje.

Disa nga objektivat e hixhabit

Hixhabi paraprin çështje të rëndësishme

Udhëheqësi, imam Khamenei, thotë: “Në shoqërinë tonë, vlerat islame duhet të ringjallen. Megjithëse hixhabi paraprin çështje të rëndësishme, ai, në vetvete, është një çështje që ka vlerë. Ne, e mbështesin fort hixhabin, sepse ruajtja e tij e ndihmon gruan, që të arrijë gradat më të larta shpirtërore dhe t’i mbrojë ato nga rrëshqitja në rrugë.”

Mbulesa ndihmon për të arritur bukurinë e vërtetë dhe përsosjen e përhershme.

Shkëlqesia e tij, imam Khamenei, thotë: “Unë them se tendenca kah zbukurimi, në shoqërinë tonë, gradualisht përgjatë viteve, është venitur. Unë nuk e kundërshtoj pamjen e zbukuruar, në kufijtë e pëlqyeshëm dhe të pranueshëm, mirëpo, nëse do të merrte një formë abuzimi, do të bëhej pispillosje e stolisje në veshje dhe zbukurim, stolisje me ar dhe xhevahire, prandaj gratë duhet të frenohen në këtë dhe të kuptojnë mirë rëndësinë e çështjes, të vetëpërbahen, që t’i kushtohet më shumë rëndësi bukurisë së brendshme se sa asaj të jashtme.”

Hixhabi ruan nderin e gruas

“Çdo lëvizje që bën përpjekje për të mbrojtur gruan, shtylla e saj kryesore duhet të jetë ruajtja e nderit të gruas. Sikurse e kam thënë më parë, Perëndimi nuk i ka dhënë rëndësi çështjes së nderit të gruas dhe nuk është kujdesur fare për këtë gjë. Rezultati i gjithë kësaj çoi drejt paturpësisë.”

Nderi i gruas është elementi më i rëndësishëm i personalitetit të saj, është një mjet për lartësimin e personalitetit të gruas, nderimit dhe respektimit të saj para syve të të tjerëve, madje edhe para syve të burrave të paturpë. Kështu, pra, nderi i gruas është shkak i respektimit të personalitetit të saj.

“Kështu, pra, hixhabi, anëtarët e shtëpisë e familjarët dhe jo anëtarët e shtëpisë jo familjarë, shikimi dhe mosshikimi, të gjitha këto çështje dhe ligje janë vendosur për ta mbajtur të shëndoshë e të pastër nderin e femrës. Islami i kushton kujdes çështjes së dëlirësisë së gruas. Sigurisht edhe dëlirësia e burrit është e rëndësishme, sepse dëlirësia nuk është vetëm për femrën, përkundrazi, edhe burri duhet të kujdeset për dëlirësinë. Gjithçka ka të bëjë me atë që burri ka fuqi në shoqëri dhe forcë më të madhe se femra dhe si rrjedhim, ai mund t’i bëjë padrejtësi femrës, prandaj edhe ka kërkuar prej gruas që të rezervohet më shumë.

Po të shikoni botën, do të shihni se një nga problemet e gruas, në botën perëndimore e sidomos në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, është shfrytëzimi i fuqisë së meshkujve dhe abuzimi me dëlirësinë e grave.

Me të vërtetë, statistikat që kanë dhënë vetë zyrtarët në Amerikë, janë vërtet të frikshme, pasi çdo gjashtë sekonda, ndodh një sulm dhune. Shikoni, pra, shkallën e rëndësisë së dëlirësisë. Kur ata e neglizhuan dëlirësinë, situata arriti deri në këtë pikë, çdo gjashtë sekonda ndodh abuzim dhune, në kundërshtim me tendencën e gruas. Burri përdor forcën e tij, një burrë mizor, zullumqar, i shturur, jo i dëlirë, dhunon dëlirësinë e gruas.

Nuk ka asnjë dyshim se Islami i shënon këto. Çështja e hixhabit, që Islami e miraton deri në këtë pikë, bëhet për shkak të dhunës që shohim në botë.”

Hixhabi siguron jetën e gruas

Në pjesën e mëparshme, është cituar një hadith, rreth rëndësisë e hixhabit, në sigurinë e gruas. Për të shtuar më tepër kapacitetin e nocionit të sigurisë, ne themi që siguria nuk përkufizohet vetëm me sigurinë trupore, përkundrazi ajo ka një përgjithësim shpirtëror dhe mendor.

Udhëheqësi ynë, imam Khamenei, thotë: “Me qëllim që të mos ketë përzierje dhe të ruhen kufijtë etikë, Islami ka përcaktuar hixhabin për gruan. Ky hixhab është një nga mjetet e sigurisë, pasi, me të, gruaja gjen sigurinë e saj, kurse

burri mysliman gjen sigurinë e tij. Kur hiqet hixhabi, gruaja i afrohet lakuriqësisë dhe shthurjes, së pari, hiqet siguria e gruas dhe së dyti, hiqet sigurimi i burrave.

Prandaj, Islami ka përcaktuar hixhabin, me qëllim që mjedisi të jetë i shëndoshë dhe i sigurt dhe gruaja të mund të bëjë punën e saj në shoqëri. Gjithashtu, edhe burri të mund të kryejë përgjegjësitë e tij. Ky hixhab është prej ligjeve të qarta islame dhe një nga dobitë e tij është ajo që përmenda më sipër. Por ka edhe dobi të tjera.”

Pra, hixhabi ruan sigurinë shpirtërore dhe trupore të shoqërisë dhe nuk është e drejtë që të thuhet se siguria e gruas është e garantuar plotësisht në kohën tonë, pasi, sikurse u citua nga fjala e udhëheqësit, ka statistika të frikshme për dhunën seksuale që ndodh nëpër botë, për të cilën thuhet e civilizuar.

Siguria shpirtërore, më e përgjithësuar është te burri se sa te gruaja. Ai nuk ngopet me pasuri dhe të mira. E tillë është edhe çështja në lidhje me problemet e epshit seksual. Ai është binjak i një lloj ngjyre ndjenje dhe vetëmohimi. Mungesa e sigurisë, bashkë me rolin e vet, të çon drejt problemeve dhe sëmundjeve shpirtërore dhe psikologjike.

Një nga shkaqet e shtimit të përqindjes të sëmundjeve psikologjike në Perëndim është dalldia dhe shfrenimi që merret nga gazetatat, revistat, festat, kinematë dhe rrugët.

Izolimi i kënaqësisë seksuale, për nga pikëpamja e Islamit, bëhet brenda familjes dhe me bashkëshortë të ligjshëm, që japin kontributin e tyre në ruajtjen e sigurisë shpirtërore, mendore dhe barazisë së përgjithshme të shoqërisë. Kjo na çon në thellimin e lidhjeve të sinqerta dhe të ngushta midis individëve të familjes.

Gjithashtu, kontribuon edhe nga ana sociale, duke ruajtur investimin e fuqive në drejtim të punës dhe prodhimit. Përfundimi është ngritja e vlerës dhe vlerësimi i gruas përballë burrit.

Pra, hixhab, do të thotë kufizimi i ngjyrave të kënaqësisë seksuale, pavarësisht nëse është me të parë, me të dëgjuar apo me të prekur në mjedisin e familjes dhe martesës ligjore, kurse mjedisi shoqëror dhe personal mbetet i siguruar. Individu promovohet në mendim dhe në shpirt dhe, rrjedhimisht edhe shoqëria promovohet dhe zhvillohet.

Udhëheqësi, imam Khamenei, e ka tërhequr vëmendjen kah kësaj çështjeje të rëndësishme: “Në Perëndim ka diçka që të mbush sytë me lot e ajo është mosekzistenca e dallimit në biografinë sociale të burrit dhe gruas në shoqëri. Ashtu sikurse burri hyn në shoqëri dhe bëhet pjesë e saj, po kështu edhe gruaja hyn me të njëjtën lehtësi dhe i bashkëngjitet të pranishmëve. Kjo është diçka pozitive, por është sipërfaqësore e virtuale. Në krahun tjetër, ka shumë anë negative.

Burri dhe gruaja, brenda familjes nuk janë të barabartë. Statistikat dhe lajmet e pakundërshtueshme, jo fjalë të minberit dhe parullat, na tregojnë për dhunën ndaj gruas, madje edhe burri dhunohet, por ai është burrë dhe ka duar më të forta. Ajo që dhunohet në mënyrë absolute është femra. Kjo ndodh sepse bashkëshorti i saj ka lidhje jashtëmartesore, intime me femra të tjera përveç asaj dhe nuk i ka lidhjet e ngrohta e të singerta me bashkëshorten e tij. Kjo është goditja më e fortë për gruan, pasi gruaja e lidh jetën me bashkëshortin e vet, duke pasur midis tyre lidhje të singerta emocionale dhe që të jenë më të afërt me njëritjetrin, se sa me pjesën tjetër të botës.”

Margjinat e çështjes së hixhabit (*shikime dhe mbrojtje*)

Nuk mjafton legjitimimi i një çështjeje, përkundrazi duhet të gjendet mënyra për ta zbatuar dhe për ta mbështetur plotësisht realizimin dhe qëllimin e tij.

Detyra e gruas është specializimi në të gjitha fushat mjekësore

Udhëheqësi, imam Khamenei, ka propozuar këtu një çështje që mbështet zbatimin e hixhabit: “Këtu bëj me dije domosdoshmërinë e specializimit të femrave në të gjitha degët mjekësore dhe të mos mjaftohen vetëm me mjekësinë femërore, për sa kohë ne besojmë në domosdoshmërinë e ekzistencës së ndarjes midis burrit dhe gruas dhe mbështesim fort refuzimin e përzierjes së lirë midis burrit dhe gruas.

Ne besojmë te hixhabi, në kuptimin e tij të vërtetë, prandaj ne nuk mund ta neglizhojmë çështjen mjekësore, pra, që na bën ne përgjegjës dhe na angazhon për të pasur femra mjeke në të njëjtin raport me mjekët burra, deri sa femra të specializohet në fushën mjekësore që dëshiron. Nuk ka nevojë për paragjykimin e asaj ndarjeje.

Disa femra mendojnë se duhet të studiohet vetëm për specializimet për femrat dhe ky specializim i tyre duhet të mbetet i kufizuar me sëmundjet e shtatzënisë dhe të lindjes. Mirëpo çështja nuk është e tillë.”

Hapja e instituteve arsimore për femra

Me kanë thënë se ka një qëllim dhe flitet për të bërë një universitet vetëm për femrat, në dashtë Allahu, domethënë profesore, drejtore dhe studente, madje edhe bordi drejtues të jetë femëror. Një universitet vetëm mjekësor. Kjo është një ide shumë e mirë.

Rreziku i tërheqjes së të huajve dhe zbukurimi

Udhëheqësi, imam Khamenei, e hedh shikimin në domosdoshmërinë e kujdesit ndaj rrezikut të tërheqjes së të huajve: “Në Islam ka një pengesë midis mashkullit dhe femrës, kjo është një çështje që nuk mund të mohohet. Kjo pengesë ekziston, sepse ka një urtësi për të dhe një të vërtetë që patjetër duhet të ekzistojë.”

Kur thuhet se veçimi i një burri dhe një gruaje brenda një dhome të vetmuar është haram, pa dyshim se kjo ndalesë ka një kuptim të thellë dhe të urtë. Kjo është e vërtetë. Çdo burrë dhe grua, nëse kthjellohet, atëherë ata të dy do ta zbatojnë këtë ligj.

Ligji ia ndalon femrës të shfaqë bukurinë e saj përpara burrave apo një grupi meshkujsh, është një i ligj i saktë.

Kultura islame e përçmon zbukurimin e femrës përveç bashkëshortit.

Mos përzierja negative

Udhëheqësi, imam Khamenei, thotë: “Në mesin e ligjeve islame është çështja e hixhabit dhe çështja e pranisë së një kufiri midis burrit dhe gruas. Ky kufi është në një zonë të veçantë dhe nuk përfshin të gjitha vendet.”

Femra duhet ta vëzhgojë mirë përzierjen e keqe. Sigurisht, jo çdo përzierje është e keqe, pasi nuk ka asnjë pengesë në përzierjen për ruajtjen e ekuilibrave legjitime.

Supozoni se një grua merr një post të lartë qeveritar dhe ky post është shumë i rëndësishëm. Shumë burra e duan atë post. Deri këtu s’ka asnjë problem dhe nuk ka asnjë pengesë që gruaja ta marrë atë post. Gruaja mund të presë me mençuri e urtësi, në zyrën e saj, me mijëra burra dhe kandidatë.

E tillë është situata edhe në fushën e përbaljes dhe në fushën e luftës, njësoj si fusha ku ka marrë pjesë e nderuara Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*), e nderuara Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*), e nderuara Hakime apo motra e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ku vetë Imami i ka kërkuar atij që erdhi ta kërkojë për bashkëshorte, se duhet të pyetet ajo.

Dituria dhe stolitë

“Dija, me gjithë madhësinë e vet, nuk krahasohet fare përpara moralit shpirtëror që Allahu i Madhëruar ia ka bërë dhuratë femrës. Nëse një femër arrin shkallën më të lartë të diturisë, mirëpo është e rëndomtë në çështjet njerëzore dhe në lidhjet e saj njerëzore, si njëra nga dy gjinitë, a shikoni vallë ndonjë vlerë tek ajo? Sigurisht, gruaja e ditur është më pak e ekspozuar ndaj vulgaritetit. Pa dyshim se një nga plagët e analfabetizmit është rritja e raportit të vulgaritetit të gratë dhe vulgariteti nuk ka një kufi të caktuar.

Në të vërtetë, natyra esenciale njerëzore, është e dashur për gruan dhe burrin dhe, kur ata të dy mësojnë dijen dhe urtësinë, atëherë ata ecin drejt nxjerrjes gjithmonë e më shumë në pah dhe pastrimit të asaj esence.”

Stolisja është dhunë ndaj gruas

Gruaja duhet ta njohë pozitën e vërtetë të saj dhe nuk duhet të dhunohet për shkak se është femër, pasi kjo është një punë shumë e ligë.

Dhuna që ka prekur gruan dhe është quajtur padrejtësi apo dhuna që nuk quhet dhunë, mirëpo në realitet është dhunë, sikurse orientimi i saj kah zbukurimi, stolisja dhe konsumi, zbukurimi i tepruar, shpenzimi i tepërt dhe shndërrimi i saj kah metodës së konsumit, e gjitha kjo është një dhunë e madhe ndaj gruas.

Ne edhe mund të themi që kjo është dhuna më fortë ndaj saj, sepse kjo e huton atë totalisht ndaj qëllimeve, objektivave të saj integruese, duke e zhvendosur prej tyre dhe duke e angazhuar me punë shumë të vogla dhe përbuzëse. Kjo është ajo që ka bërë sistemi mizor mbretëror. Ne tani duhet t'i qëndrojmë përballë.

El abaetu është lloji më i mirë i hixhabit

Ne shikojmë se studimet dhe hulumtimet e bëra e që vërtiten rreth mbulesës së gruas, janë të mira, mirëpo ju femra e keni për detyrë të jeni të kujdesshme, që secili nga

këto studime, për mbulimin e gruas, nuk duhet të ndikojë për t'u sulmuar nga media perëndimore, pasi, nëse do të ndikojë, atëherë do të dështojë.

Le të mendojmë, për shembull, se hixhabi është i mirë, por nuk ka nevojë për mantel. Ky është mendim i gabuar. Me këtë nuk nënkuptoj se hixhabi duhet të jetë vetëm me mantel, përkundrazi unë po them se manteli është një nga llojet më të mira të hixhabit.

A mendoni vallë se, nëse ne e braktisim mantelin dhe fshihemi me maska, Perëndimi do na lërë të qetë? Kurrsesi jo, nuk do të kënaqet me këtë. Ata duan që ne të ndjekim kulturën e tyre fatkeqe.

MODELE ISLAME

Modeli femëror në Kur'anin Famëlartë

“Kur Allahu do të marrë një shembull, si p.sh, për besimtarët përgjatë historisë së profecive, Ai ka thënë në Kur'an: **“Allahu mori për shembull gruan e Faraonit.”**

Pavarësisht se ka shumë shembuj të besimtarëve në kohën e Profetit Musa (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), si dhe të atyre që u sakrifikuan në rrugën e besimit, Allahu ka përmendur emrin e modelit femëror. Cili është shkaku i kësaj? Mos vallë Allahu i Lartësuar ka dashur të pozicionohet në krah të femrave? Apo ekziston diçka tjetër?

Çështja është se kjo grua, në atë kohë, arriti shkallën më të lartë të lëvizjes shpirtërore, sa që nuk kishte shembull, kështu që nuk mund të japë një shembull tjetër ndryshe. Kjo ka ndodhur përpara lules Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe para të nderuarës, të madhes Merjem (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ajo është gruaja e Faraonit dhe jo e një Profeti apo djali të një Profeti, apo bashkëshorte Profeti apo familjare e ndonjërit prej Profetëve. Edukata shpirtërore, udhëzimi dhe lartësimi i asaj gruaje i ka dhënë asaj gradën, statusin e shëmbëlltyrës.

Sigurisht se ka një pikë të kundërt të saj, d.m.th. se ka edhe një shëmbëlltyrë të së keqes, shthurjes. Pa dyshim se Allahu e ka marrë shembullin për njerëzit më të këqij dhe ka thënë: **“Allahu ka dhënë si shembull për ata që nuk**

besojnë, gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga robtë Tanë të ndershëm dhe i tradhtuan ata. Prandaj, ata nuk mund t'i mbrojnë aspak nga Allahu (Ditën e Gjykimit) e atyre të dyjave do t'u thuhet: 'Hyni në zjarr, me ata që po hyjnë!'.¹⁸

Allahu përmend dy gra, si shembulli më i keq i njerëzve. Sa shumë mohues ka pasur në kohën e Nuhut dhe të Lutit (*Paqja qoftë mbi ta!*), mirëpo Kur'ani nuk i përmend ata si shëmbëlltyrë, përkundrazi, merr për shembull gratë e Nuhut dhe të Lutit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ku buron ky kujdes për gjininë femërore dhe ky interes për lartësimin e saj? Ndoshta, Kur'ani, më këtë, ka dashur të na tregojë pikëpamjen e gabuar të njerëzve në kohën e zbritjes së Shpalljes. Është për të ardhur keq, sepse ajo pikëpamje vazhdon edhe sot të jetë e gabuar. Ka dashur t'u tërheqë vërejtjen banorëve të Gadishullit Arabik, të cilët ishin prej atyre që i varrosnin të gjalla vajzat e tyre, si dhe perandorive më të bukura të asaj kohe, asaj romake dhe perse.

¹⁸Sure "Et Tahrim", ajeti 10.

Gratë e para të Islamit

Gratë dhe burrat e parë të Islamit krenoheshin dhe mburreshin me fenë e tyre, u besonin ligjeve dhe rregullave të fesë, i zbatonin ato pa asnjë polemikë, sepse ata besonin dhe respektonin në vlerat dhe ligjet e fesë islame.

Transmetohet nga gratë e ensarëve se ato, sapo zbriti surja “Nur”, ajeti 33: **“le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre”**, burrat e tyre u kthyen kah tyre, duke ua lexuar ajetin që kishte zbritur Allahu për to. Burri ia lexonte gruas së vet, vajzës së vet, motrës së vet, si dhe të afërmve. Nuk mbeti

asnjë femër pa e zbatuar me përpikëri ajetin, duke e konsideruar dhe duke besuar atë që kishte zbritur Allahu në Libër, duke e ndjekur të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) edhe sikur mbi kokat e tyre të ishin korbat.¹⁹

Kjo është shoqëria e parë e Islamit, e mbushur me besim, duke i marrë me forcë dhe shpejtësi angazhimet dhe përgjegjësitë, sepse urdhri i Allahut të Mençur, të Urtë ka zbritur. Nuk kishte asnjë nevojë për propagandë, botime, për libra, për hutbe apo sqarim të anëve dëmtuese dhe të këqijat e tij, të mirat dhe dobitë e diçkaje, prandaj burrat dhe gratë kanë qenë në rrugën e përsosjes së vërtetë shpirtërore. Ata përparuan, u zhvilluan dhe triumfuan, edhe pse ishin të prapambetur dhe të mposhtur.

Nëse gratë duan të përparojnë, të zhvillohen dhe ta largojnë dhunën ndaj tyre, ato nuk duhet bëjnë gjë tjetër, përpos të besojnë fenë e tyre dhe të zbatojnë ligjet e saj.

Imam Khamenei thotë: “Nëse mendimi islam do të zbatohet siç duhet, në çdo fushë, duke e përkufizuar qartë dhe pastër atë mendim, nuk ka asnjë dyshim se shumë probleme dhe mbase të gjitha problemet, do të zgjidheshin në të ardhmen.

¹⁹Tefsiri i Ibn Kethirit, vëll. 3, f. 295.

Por është për të ardhur keq, sepse shumë njerëz, për shumë çështje, nuk i njohin mendimet kur'anore.

Një prej tyre është kjo çështje (çështja e gruas), duke ia dhënë të gjithë kujdesin dhe interesin e tyre zakoneve, traditave, fabrikimeve dhe mendjeve jo të shëndosha, si dhe duke kopjuar kulturën perëndimore, fenë perëndimore ndaj Islamit. Ata vërtet i njohin ato më shumë, prandaj edhe vazhdojnë akoma të ecin në rrugën e gabuar.”

Po ju tregojmë disa karakteristika të grave të para të fesë.

Në fillimet e Islamit, gruaja kishte përgjegjësinë e detyrës së kurimit të të plagosurve të luftës në fushëbeteja, madje ajo e vishte mburojën dhe dilte me shpatë në luftëra të ashpra. Në të njëjtën kohë, kujdesej për t'u dhënë gjë fëmijëve të saj, djemve të saj brenda shtëpisë së saj, duke u dhënë atyre edukatën islame, duke u kujdesur për hixhabin e saj dhe mes gjithë atyre gjërave, ajo nuk kishte konflikt.

“Ka pasur edhe gra të shquara në ballë të Islamit, kanë qenë të pranishme edhe në fushë të luftës. Një pjesë e tyre ka marrë pjesë në luftime, pasi ka pasur edhe fuqi fizike, pavarësisht se Islami nuk e detyron gruan, duke e çliruar prej kësaj, sepse nuk harmonizohet as natyra e tyre trupore dhe as emocionet.

Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*)

Myslimanët dhe kultura e tyre ka një grua madhështore, Fatimen. Nuk ka asnjë dyshim se Allahu i Madhëruar është i Aftë që ta bënte më të madhen grua, në shumë prej popujve të tjerë, mirëpo Ai e zgjodhi të ishte për ymetin islam. Ajo është një argument i madh dhe paralajmërim për ne, që ta kemi përpara syve këtë model të lartë dhe të përpiqemi të arrijmë gradat e saj.

Kështu, pra, gratë tona duhet të nxjerrin mësim nga Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*)

Detyra e femrës myslimane është që të përpiqet për veten e saj në rrugën e urtësisë, të diturisë, si dhe në rrugën

e edukimit shpirtëror dhe moral. Të jetë pararojë në fushën e xhihadit dhe të përleshjes (me të gjitha llojet) dhe të mos i japë asnjë rëndësi bukurive të kësaj bote dhe fasadave të saj të lira. Le të jetë dëlirësia e saj, këmbëngulja dhe pastërtia e saj në atë shkallë, që të mund ta largojë automatikisht shikimin e të huajve.

Kjo është Fatimeja (*Paqja qoftë mbi të!*), modeli shembull i grave, me të gjithë karakteristikën e lavdëruar. Ajo është universale, kështu që ju merrni mësim. Ajo është adhuruesja, pra, bëhuni edhe ju adhuruese. Ajo është luftëtarja, atëherë bëhuni edhe ju luftëtare. Ajo është dëlirësia vetë, kështu që edhe ju bëhuni të dëlira.

Femra iraniane

Po t'i krahasojmë situatat e gruas iraniane, para dhe pas revolucionit, do të shikohen shumë dallime.

Në periudhën e Shahut, paturpësia jo vetëm në qytetin e Teheranit, por edhe në disa qytete të tjera, ia tejkalonte dhe atyre qyteteve evropiane, që njihen si të tilla.

Femra e zakonshme përëndimore vishej me rroba dhe mbulohej, kurse këtu situata nuk ishte e tillë. Ne as nuk shikonim, as nuk dëgjonim dhe as nuk dinim gjë, kurse pamjet që ne shikonim atëherë e që kanë mbetur sot në

mendjet tona, e habisnin fare, e hutonin njeriun dhe e bënë atë të pyeste veten: “Pse ndodh kjo?”

Erdhi koha e revolucionit dhe e përmbysi gjendjen. Hixhabi, që në kohën e Shahut, ishte një njollë turpi, ajo u bë shenjë e dëlirësisë, e pastërtisë dhe e përsosjes.

Kjo është pagabueshmëria, mbrojtja e Islamit, e cila u demonstrua në fytyrat e grave revolucionare në ditët e revolucionit, por edhe aktualisht. Falënderimi i takon Allahut!

Të mos thotë kush se femrat nuk mund të marrin dije, nëse mbajnë veshur hixhabin, nëse ruajnë dëlirësinë apo, nëse drejojnë shtëpinë dhe edukojnë fëmijët. Sa shumë gra punëtore kemi ne në fusha të ndryshme të shoqërisë sonë! Ka një numër të madh studentesh universiteti, që janë pararojë, po kështu të diplomuara në nivele të larta, mjeke të shkëlqyera, në fusha të ndryshme shkencore.

Gratë tona sot, në Republikën Islamike, kujdesen dhe e ruajnë dëlirësinë e tyre, pagabueshmërinë dhe pastërtinë e tyre si femra, e ruajnë plotësisht hixhabin, i edukojnë fëmijët e tyre më modelin islam, po kështu edhe detyrat bashkëshortore, ashtu si këshillon Islami. Ato merren edhe me aktivitete shkencore dhe kulturore.

Me këtë punë, femrat e Iranit formojnë një model dhe shëmbëlltyrë për të gjitha femrat e botës, në veçanti, për

femrat myslimane. Ato miratojnë se gruaja myslimane është luftëtarja e arsimuar e lëvizjes dhe, në të njëjtën kohë, është e veshur me hixhab dhe e dëlirë. Prandaj mos qëndro midis zbukurimit dhe dijes dhe as mos rreshto njëri pas tjetrit paturpësinë dhe tendosjen.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
PJESA E PARË	
GRUAJA.....	7
Rëndësia e trajtimit të çështjes së gruas.....	8
Kurimi i problemeve të gruas.....	10
Dështimi i qytetërimeve në zgjidhjen e çështjes së gruas..	11

Figura e gruas përgjatë historisë.....13

PJESA E DYTË

QYTETËRIMI PERËNDIMOR.....18

Padrejtësia aktuale është vazhdim i padrejtësisë së hershme.....19

Padrejtësi “elegante”20

Femra në kulturën perëndimore.....23

Islami është konkurrues.....26

Lëvizjet për çlirimin e femrës, në Perëndim, janë lëvizje shfrytëzuese dhe përfituese.....27

Të këqijat e Perëndimit (e tëra është tragjedi).....29

Reforma e re në Perëndim.....32

Kultura perëndimore duhet të mbrojë veten e saj.....36

PJESA E TRETË

SHKAQET DHE MËNYRA E KURIMIT.....39

Shkaqet e padrejtësisë ndaj femrës.....40

Injoranca e njerëzve.....41

Ngacmimi i meshkujve.....42

Përftimi material.....43

Trajtimi i të drejtave të femrës.....44

Mosimitimi i verbër.....44

Urtësia dhe mosveprimi.....45

Manifestimi i të drejtave të gruas me gjuhën e kohës.....47

Domosdoshmëria e distancimit nga studimet devijuese...48

Reformimi dhe ndryshimi i ligjeve.....49

Qëllimi i mirë.....50

PJESA E KATËRT

FYTYRA E NDRITSHME.....	51
Islami është zgjidhja.....	52
Gruaja në shoqërinë islame.....	55
Mbrojtja e gruas ndërmjet kulturës perëndimore dhe asaj islame.....	57
A ka dallim midis burrit dhe gruas?.....	59
Hixhabi.....	66
Një luftë për hixhabin dhe thirrje për të qëndruar fort.....	66
Dallimi midis hixhabit të kohës së injorancës dhe hixhabit islam.....	69
Disa nga objektivat e hixhabit.....	70
Margjinat e çështjes së hixhabit (shikime dhe mbrojtje).....	76
El abaetu është lloji më i mirë i hixhabit.....	81
Modele islame.....	82
Modeli femëror në Kur'anin Famëlartë.....	82
Gratë e para të Islamit.....	85
Fatime Zahra (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	88
Femra iraniane.....	89

المرأة، حقوق و حرية و حجاب

السيد علي الخامنشي

تيرانا 2020

اسم الكتاب: المرأة، حقوق و حرية و حجاب

المؤلف: السيد علي الخامنئي

المترجم: الحاج ولنت مريا

التصحيح الأدي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا